




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 10 Janar 2014

ISSN 2225-2959



“BORXHI & HUAMARRJA”



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



ANËTARËT E AAB

ALPHA BANK	BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	CREDINS bank	CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT TE SHQIPTARE
Emporiki Bank CREDIT AGRICOLE GROUP	Fibank First Investment Bank	Banka Nderkombetare Tregtare International Commercial Bank	INTESA SANPAOLO BANK Albania
NBG Bank	ProCredit Bank	Raiffeisen BANK	SOCIETE GENERALE ALBANIA
TIRANA BANK	UNION BANK	UBA United Bank of Albania Banka e Bashkuar e Shqiptare	VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA

■ www.aab.al

Përmbajtja

EDITORIAL

A jemi të mbytur në borxh (të keq)???
nga *Elvin MEKA*

f.5

TEMA E DITËS

Borxhi privat në Shqipëri – një ekzistencë pa shkëlqim
nga *Altin HOTI*
Rritja e borxhit publik - Një e keqe për një të mirë
nga *Spiro BRUMBULLI*

f.6

f.9

KËNDI I GAZETARIT

BORXHI - nje realitet i kudondodhur
nga *Aurora SULÇE*

f.11

INTERVISTA

Intesa Sanpaolo Bank Albania – Mbështetemi fort në
Shqipëri - *Intervistë me Silvio PEDRAZZI*

f.13

SISTEMI BANKAR

Platforma e Bankës së Shqipërisë për trajtimin e huave me
probleme – Një qasje e re nga *Gerond ZIU*

f.14

Çatia e sigurisë nga *Roland TASHI*

f.17

FORUMI I EKSPERTËVE

Stabilizimi - Kryefjala për sektorin financiar shqiptar
nga *Enkeleda SHEHI*

f.19

Sistemi shqiptar i garancive, nën dritën e ndryshimeve të
fundit nga *Sokol ELMAZAJ dhe Sabina LALAJ*

f.22

Plani i auditimit të brendshëm i bazuar në rrezik në
sektorin bankar - Disa mendime nga *Holtjana BELLO*

f.25

KËNDI I EKONOMISTIT

Politikat monetare: Stabiliteti i çmimeve përballë
stabilitetit financiar nga *Adrian CIVICI*

f.27

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

Kolosët universitarë botërorë në fushën e ekonomisë
sillen në shqip nga UET Press nga *Andi BIDOLLARI*

f.31

Aktivitetet nga bankat

f.33

RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.35

TEKNOLOGJI

Mbrojtja e komunikimeve nga *Oerd CUKALLA*

f.38

AUDITORI FINANCIAR

Çështje dhe pikëpamje rreth bankingut privat
nga *Roberto RUOZI*

f.41

AAB

Veprimtaritë e Shoqatës Shqiptare të Bankave

f.43



BANKIERI është publikimi zyrtar
i Shoqatës Shqiptare të Bankave
i cili i dedikohet kryesisht sektorit
bankar shqiptar. BANKIERI i
jep lexuesit një informacion të
vlefshëm mbi arritjet e industrisë
në përgjithësi dhe të bankave
tregtare në veçanti.

Bankieri

Nr. 10, Janar 2014

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Redaksia:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Junida Tafaj (Katrosi)

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Anduena Manushi

Redaktore

Alban Nexhipi

Fotograf

Design & Layout: Ladybird Creations

Shtypi:  Gentigrafik

Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

NBG Bank Shqipëri

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Raiffeisen Bank Shqipëri

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Alpha Bank Shqipëri

Frédéric BLANC

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Societe Generale Shqipëri

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i

Fibank Shqipëri

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Adrian CIVICI

President & Drejtor i Shkollës Doktorale

Universiteti Europian i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Drejtor i Kabinetit të Ministrisë të Financave

Enkeleda SHEHI

Kryetare e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE

Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org; www.aab.al

Kredia Konsumatore Alpha Realizo

Kredia konsumatore Alpha Realizo, është kredia e cila ju mundëson plotësimin e dëshirave dhe nevojave tuaja. Ajo është ideuar enkas për të gjithë ju që dëshironi të blini mobilje të reja ose pajisje elektroshtëpiake për shtëpinë tuaj apo për të mbuluar çdo nevojë tjetër të jetës tuaj të përditshme.

- Këste mujore të përballueshme
- Afat ripagimi deri në 7 vjet
- Aprovim brenda 24 orëve*



TA BLESH
APO TË MOS
E BLESH?

Alpha Realizo
Kjo është përgjigjja!

*E vlefshme nëse dokumentacioni i paraqitur në degë është i plotë

Klientët pagamarrës: **12M BTH + 10%** Klientët standard: **12M BTH+ 12%**



ALPHA BANK

A JEMITË MBYTUR NË BORXH (TË KEQ)???



nga **Dr. Elvin MEKA**¹
Kryeredaktor

Problemi i vërtetë nuk është sa borxh kemi marrë, por sa fuqi ripaguese kemi dhe sa të qëndrueshme janë rrjedhat tona të ardhshme të parasë. Kjo është pikërisht rrënja e problematikës së sotme për huamarrësit shqiptarë, qoftë ky qeveria, biznesi apo ekonomitë familjare.

Borxhi nuk përbën thjesht fjalën e ditës sot, përkundrazi është tashmë fjalë e modës, kudo ku shkojmë dhe çfarëdo që dëgjojmë rreth ekonomisë, gjatë 24 orëve dhe 7 ditëve të javës. Kjo fjalë fitoi këtë vend kryesisht pas shpërthimit të krizës së fundit ekonomike dhe financiare të vitit 2008, e veçanërisht në vendet europiane, për të cilat mund të pohohet se janë të zhytura në borxhe. Debati i fundit i nxehtë që mbahet mend në shkallë globale, lidhur me borxhin, ishte rasti i krizës së borxheve të botës së tretë, e në veçanti ai i vendeve të Amerikës Latine. Një nga zgjidhjet “magjike”, përveç ndërhyrjeve të FMN-së, ishte idea e shkëlqyer e Sekretarit të Thesarit Amerikan z. Nicholas F. Brady, për ta “titullizuar” atë, nëpërmjet emetimit të obligacioneve “Brady”. Gjithsesi, madhësia e këtyre borxheve dhe tipologjia e vendeve huamarrëse nuk ka të krahasuar me gjendjen e sotme të borxhit në Europë, duke përfshirë këtu si borxhin publik, ashtu dhe atë privat, ndërkohë që “magjia” në ditët e sotme kërkohet në nivel të rregullatorëve dhe rregullave.

Por si paraqitet gjendja në Shqipëri? A jemi të zhytur në borxhe? Askush nuk mund të japë një përgjigje shterruese, pasi as shifrat e as madhësia e tij nuk mund të ndihmojnë për një gjë të tillë. Aktualisht, nuk ekziston një nivel “shkencor” lidhur me eficiencën apo rrezikshmërinë e madhësisë së borxhit, përveç rastit të fushës së financës së ndërmarrjes; përkundrazi ekzistojnë vetëm disa kritere dhe udhëzime të paracaktuar rreth madhësisë së borxhit publik, të cilat si rregull, janë shkelur me ndërgjegje nga po vetë ata që i kanë vendosur. Duhet të jetë e qartë se, kur flasim për borxhin, duhet të merret parasysh si borxhi publik, ashtu dhe ai privat. Për hir të faktit duhet pohuar se, në kuadër të madhësisë, kjo barrë borxhi nuk është në nivele alarmante; faktikisht borxhi publik ndodhet përpara “dritës së verdhë” ndërsa borxhi privat vlerësohet

i ulët, nëse e krahasojmë me madhësinë e tij në vendet e rajonit, pasi me atë të vendeve të zhvilluara as që ka të krahasuar (është shumë i ulët).

Pse duhet të shqetësohemi atëherë për borxhin, për sa kohë që barra e tij nuk duket se ka ndezur ende “dritën e kuqe”? Fatkeqësisht, shifrat e madhësisë nominale dhe bruto të borxhit janë disi çorientuese. Problemi i vërtetë nuk është sa borxh kemi marrë, por sa fuqi ripaguese kemi dhe sa të qëndrueshme janë rrjedhat tona të ardhshme të parasë. Kjo është pikërisht rrënja e problematikës së sotme për huamarrësit shqiptarë, qoftë ky qeveria, biznesi apo ekonomitë familjare. Në kushtet kur vendi po ecën në një shteg të rritjes së dobët, por disavjeçare ekonomike, e ku pritshmëritë ekonomike nga ana e ekonomive familjare dhe bizneseve duken jo optimiste, ata thjesht po tkurrin shpenzimet, investimet dhe punësimin, duke kontribuar me më pak të ardhura në buxhetin e shtetit. Për më tepër, fuqia dhe baza ripaguese e borxhit është dobësuar dhe po përqësohet që nga viti 2009, duke rritur kështu huat me probleme në banka. Rrjedhimisht, kjo gjendje hyn në një qerthull, që shndërrohet në rreth vicioz, ku financimi nga bankat bëhet një lloj realiteti i çmuar, i vështirë për t’u gjetur dhe i vështirë për t’u shitur. Ky ngërc huadhënie shndërrohet në ngërc likuiditeti dhe pagesash, i cili ushqen edhe më shumë e në vijim huat me probleme. Përfundimisht, problemi nuk është më borxhi fillestar, por ai i akumuluar e i pashlyer, që rritet përditë, saqë po kthehet në “elefantin brenda në dhomë”, e ku bankierët janë po aty, përballë tij. Intuitivisht, ky quhet rrezik sistemik.

Dikur, John Maynard Keynes thoshte: “Nëse ju i keni borxh një mijë paund një bankieri, juve jeni në mëshirën e tij. Nëse juve i keni borxh një milion paund një bankieri, atëherë është ai në mëshirën tuaj.”

Atëherë, kush është i mbytur në borxh (të keq)???

¹ Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

BORXHI PRIVAT NË SHQIPËRI – NJË EKZISTENCË PA SHKËLQIM



nga Altin HOTI, PhD
Dekan i Fakultetit Ekonomik
Universiteti "LUARASI"

Që në fillimet e krizës së fundit financiare, huamarrja është kthyer në "të keqen" e madhe, pa të cilën nuk bëjmë dot ndërsa destabilizimi i parametrave makroekonomikë ka transferuar vëmendjen e ekspertëve të ekonomisë të problematikat që lidhen kryesisht me borxhin publik. Ndërkohë, është lënë disi në hije një tjetër lloj borxhi, siç është borxhi privat. Analizimi i këtij treguesi, është ndoshta edhe më i rëndësishëm, pasi ndikimi negativ i tij në rritjen ekonomike është cilësisht më i madh, në raport me atë të borxhit publik.

Përgjithësisht borxhi privat i referohet borxhit që subjektet e ndryshme (fizike, juridike) marrin nga sistemi financiar, pra financat e marra për konsum, ose për investime. Është lehtësisht i kuptueshëm roli që kanë financat e lidhura drejtpërdrejt me subjektet që prodhojnë kërkesë agregate ose përmes konsumit, ose përmes investimeve, sidomos në kushtet e një krize ekonomike. Thënë ndryshe, financimi i projekteve të biznesit, ose nxitja e kërkesës konsumatore i shërbejnë rritjes ekonomike, si dhe vënies në punë të të gjithë mekanizmit ekonomik, duke përmirësuar

parametrat makroekonomikë, ndërkohë që, sa i takon prioritetit, absolutisht është më i rëndësishëm borxhi për investime private. Efekti ekonomik i investimeve është më i gjerë, përsa i takon hallkave të zinxhirit ekonomik, e më i gjatë në kohë, për vetë faktin se investimet kane një kohëzgjatje tjetër në raport me konsumin. Në realitetin shqiptar, ky lloj borxhi ka ndikim shumë më të madh në rritjen ekonomike, sidomos në kushtet kur burimet alternative të financimit të projekteve të biznesit, jashtë kanaleve bankare, janë shumë të kufizuar. Gjithashtu, në një ekonomi ku pjesën më të madhe të PPB-së e krijon sektori privat, efektin kryesor mbi rritjen ekonomike e jep pikërisht borxhi privat, ndërkohë që borxhi publik ka një efekt të vogël ose të tërthortë mbi të.

Rëndësia e borxhit privat kalon përtej shërbimit dhe ndikimit mbi rritjen ekonomike. Sipas përfundimeve të disa ekonomistëve të Universitetit të Kembrixhit, "rritja e shpejtë e ngarkesës së borxhit privat çon në mënyrë të pashmangshme në deflacion dhe në krizë borxhesh, ndërsa niveli kritik i borxhit shtetëror vetëm frenon tempin e rritjes

Stimulimi i rritjes së huadhënies private përbën një imperativ, jo vetëm nga fakti i nivelit të ulët të borxhit privat ndaj PBB-së, por dhe nga nevoja akute për sigurimin e rritjes reale ekonomike, prodhimit dhe punësimit, në një kohë kur ndikimi i politikës monetare thuajse ka shteruar, lidhur me nxitjen e huadhënies.

Në realitetin shqiptar, ky lloj borxhi ka ndikim shumë më të madh në rritjen ekonomike, sidomos në kushtet kur burimet alternative të financimit të projekteve të biznesit, jashtë kanaleve bankare, janë shumë të kufizuar.

ekonomike. Analiza e rekordeve historike më afatgjatë të dy treguesve të borxhit kanë theksuar rolin parësor, që luan huamarrja private në ndërtimin e stabilitetit financiar¹". Gjithashtu, krizat financiare kanë një ndikim shumë më të madh në dinamikën e ekonomisë, se sa krizat e buxhetit. Rënia e sektorit financiar në vitet '30 në SHBA e uli nivelin e PPB-së në masën 30%, ndërsa kriza e huave në Argjentinë e uli këtë tregues me 20%².

¹ Jordà, Òscar, Moritz Schularick, and Alan M Taylor (2013), "Sovereigns versus Banks: Crises, Causes and Consequences", CEPR Discussion Paper 9678.

² Reinhart, Carmen M and Kenneth S Rogoff (2009), *This Time is Different: Eight Centuries of Financial Folly*, Princeton, NJ: Princeton University Press.

Po borxhi privat në Shqipëri?

Sipas të dhënave të INSTAT dhe Bankës së Shqipërisë, në fund të vitit 2008 borxhi privat arriti në rreth 3,89 miliardë lekë, ku 65,4% përbëhej nga financimi i bizneseve dhe pjesa tjetër prej 34,6% i takonte individëve. Deri në vitin 2011 kemi një prirje të qëndrueshme rritjeje të nivelit të huadhënies, mesatarisht prej 11% në vit, ndërkohë që në vitin 2012 dallohet një frenim i qartë i dinamikës së rritjes, me një normë modeste 2,43%, e kjo prirje vazhdon edhe gjatë 2013-ës, ku shënohen norma negative rritjeje. Në tetor 2013 kjo hua pëson rënie prej -2,77%, krahasuar me fundin e vitit 2012. Vlen për t'u theksuar se kontributin kryesor për këtë e ka dhënë ulja në masë më të madhe e kërkesës për borxh nga ana e bizneseve, që ka efekte edhe më të mëdha në ekonomi. Ndërsa prirja e kreditimit të konsumit ka qene negative që në fillim të vitit 2009, pa shfaqur asnjë shmangie. Arsyet e kësaj sjelljeje janë deri diku të kuptueshme, nga kriza financiare që u transferua dhe në Shqipëri. Arsyet psikologjike lidhen kryesisht me mosbesimin, si dhe zbatimin e rregullave të reja nga bankat mëmë, si pasojë e krizës më të thellë në vendet e tyre të origjinës.

Disa nga problematikat, që lidhen me borxhin privat në Shqipëri mund të përmenden:

- (1) Niveli i ulët i huadhënies, si dhe frenimi i ritmeve të saj, që jo vetëm nuk stimulon mjaftueshëm rritjen ekonomike, por ka nxitur tregun e "fajdeve" dhe atë të barterit. Kjo ka rritur informalitetin e qarkullimit të parasë, ka ulur efektshmërinë e politikës monetare, si dhe eficiencën e politikave të agjencive shtetërore në tërësi, për trajtimin e kësaj problematike. Për më tepër, niveli i borxhit privat në raport me PBB-në është rreth 41% dhe konsiderohet i ulët (krahasuar me vendet e zhvilluara, p.sh.: në SHBA ky raport për vitin 2008 ishte mbi 250%, duke përfshirë edhe tregun jobankar; Portugalia dhe Greqia kishin në vitin e vitin 2009 një nivel borxhi privat (pa përfshirë sektorin jobankar) respektivisht prej 200% dhe 100% të PPP-së), çka dëshmon për një funksionim të ekonomisë nën potencialin e saj;

- (2) Monopoli i sektorit bankar për financimin e projekteve të biznesit, monopsonia e sektorit publik për të konsumuar financimin bankar të bonove të thesarit, me rreziqe minimale e këste të garantuara në kohë, duke maksimizuar pasivitetin e bankave tregtare;
- (3) Huat me probleme. Rritja e tyre deri në nivelet aktuale kanë lidhje në një masë të madhe me problemin shumë të diskutuar të borxhit publik. Ky tregues është në të njëjtën kohë edhe një ndër shkakhtarët kryesorë të frenimit të huadhënies nga bankat. Në kushtet kur subjektet nuk kanë aftësi paguese e jo thjesht nga problemet e përkohshme të likuiditetit, "ndihma" përmes borxhit të mëtejshëm, nuk mund ta shmanjë në fund falimentimin, duke e rritur edhe më tej treguesin e huave me probleme;
- (4) Mungesa e likuiditetit jo në sistemin bankar, por në ekonominë reale. Me fjalë të tjera, kemi gjendje të mirë depozitash, që nuk kanalizohen optimalisht drejt financimit të sektorit real. Pikërisht ulja e koeficientit të borxhit, duke rritur kursimet, kthehet në paradoks: rritja e shpejtë e depozitave/kursimeve thëllon rënien ekonomike dhe rrit ngarkesën e borxhit dhe kjo pasi ekonomia nuk ushqehet me financim.

...kemi një gjendje të mirë depozitash, që nuk kanalizohen optimalisht drejt financimit të sektorit real. Pikërisht ulja e koeficientit të borxhit, duke rritur kursimet, kthehet në paradoks: rritja e shpejtë e depozitave/kursimeve thëllon rënien ekonomike dhe rrit ngarkesën e borxhit dhe kjo pasi ekonomia nuk ushqehet me financim.

Trajtimi i problematikës së borxhit privat në Shqipëri

Stimulimi i rritjes së huadhënies private përbën një imperativ, jo vetëm nga fakti i nivelit të ulët të borxhit privat ndaj PBB-së, por dhe nga nevoja akute për sigurimin e rritjes reale ekonomike, prodhimit dhe punësimit, në një kohë që, sikurse pohojnë dhe ekspertët e Bankës Botërore, ndikimi i politikës monetare të Bankës Qendrore thuhet se ka shteruar, lidhur me nxitjen e huadhënies. Ulja e normës së rifinancimit është kthyer në një masë teorike, që nuk po jep rezultat konkret, pasi është niveli i lartë i huave me probleme e shumë faktorë të tjerë, që po frenojnë bankat dhe bizneset të japin e marrin borxhe. Në kushte të tilla, duhen ndërmarrë disa hapa më gjithëpërfshirës, përtej politikës monetare, si:

- (1) Evidentimi i sektorëve prioritarë, si dhe klasifikimi i përparësisë së tyre, pasi disa sektorë e kanë arritur maturimin përse i takon rolit dhe peshës së tyre në rritjen ekonomike dhe në PBB (p.sh.: sektori i ndërtimit). Edhe sipas Bankës Botërore, ka një maturim të sektorëve të ekonomisë për të gjenuar rritje reale ekonomike përmes kërkesës së brendshme³. Për këtë do të ishte i nevojshëm një dialog/tryezë e përbashkët midis aktorëve të interesuar (bankave tregtare, banka qendrore, qeveri, biznese), për përcaktimin e këtyre prioritetëve, në mënyrë që të orientohen financime reale me rreziqe sa më të vogla;
- (2) Zhvillimi dhe pasurimi i tregut financiar me instrumente të reja (si p.sh.: obligacione private etj.), ku përsëri rolin parësor do ta luanin bankat tregtare, në mënyrë që të rritet borxhi privat, por edhe të mund të sigurohet një shpërndarje/minimizim i rrezikut përmes diversifikimit.
- (3) Rritja e rolit aktiv në sipërmarrje rreziku dhe asistencë ekonomiko-financiare nga ana e bankave, pasi kjo do të krijonte më shumë elasticitet në kanalet e huadhënies, duke rritur jo vetëm sasinë e huas, por dhe cilësinë e saj;
- (4) Zgjidhja e shpejtë e borxhit të qeverisë ndaj biznesit, që do të jepte një impuls pozitiv në sektorin real të ekonomisë, duke rritur aftësinë e biznesit për të shlyer huat me probleme dhe besimin reciprok të bankave e të bizneseve, për të çliruar injektimin e financimeve aq të mirëpritura në ekonomi.

Banka juaj është banka më e sigurt



4 22 66 288 | www.bkt.com.al

Banka më e mirë në Shqipëri The Banker, Euromoney dhe EMEA Finance

RRITJA E BORXHIT PUBLIK - NJË E KEQE PËR NJË TË MIRË



nga Dr. Spiro BRUMBULLI
Drejtor Kabineti
Ministria e Financave

Ekonomia e një vendi, praktikisht, e ka të pamundur të zhvillohet pa marrë borxh. Nevoja për të përballuar shpenzimet e shumta dhe përmirësimet në cilësi të shërbimeve publike, përballimi i situatave të vështira në kohët e rënies ekonomike dhe nevoja për investime për t'i paraprirë zhvillimit dhe rritjes së mirëqenies e bëjnë të pamundur drejtimin e financave publike pa marrë borxh. Nëse borxhi është një e keqe për një të mirë, diskutimi nuk qëndron këtu. Pyetja që shtrohet dhe rëndon në politikën e borxhmarrjes është sa borxh duhet të mbash. Historia e zhvillimit ekonomik është e mbushur me raste përfaqësimi nga më të ndryshmet për rolin që ka luajtur huamarrja publike. Një borxh i kontrolluar (që do të thotë se ekzistojnë mundësi dhe kapacitete ripagimi) përfaqëson një histori suksesi; një borxh i pakontrolluar (përgjithësisht, luhet me shifra duke fshehur të vërtetën për një periudhë kohe nga frika e ndërprerjes së financimit) ka çuar në situata varfërie, mungesë stabiliteti dhe depresion. Edhe pse teoria ekonomike e justifikon dhe e mbështet huamarrjen publike, akoma sot nuk ka një formulë të mirëpranuar se sa është madhësia optimale e marrjes së borxhit publik. Edhe pse Bashkimi Europian (BE) ka vendosur një kriter për vendet anëtare që kufiri i borxhit të mos jetë më i lartë se 60% dhe deficit

Në rast se treguesi i borxhit konsiderohet i lartë për fuqinë ekonomike të vendit dhe normat e rritjes së PBB-së nuk garantojnë ripagimin e detyrimeve, shkurtimi i shpenzimeve qeveritare është pjesë e një regjimi të shtrëngimit ekonomik, ku edhe sistemi i taksave ndryshon me qëllim që të kontribuojë për të rritur të ardhurat.

buxhetor jo më shumë se 3% në raport me PBB, edhe ky kriter, siç tregoi kriza e borxhit publik, tipike për eurozonën, nuk ishte respektuar.

Çështja e madhësisë së borxhit publik nuk është një çështje numrash. Pas numrit tregohet sigla e monedhës dhe pas saj do të thotë që duhen ripaguar ato para. Këtu është edhe çelësi i zgjidhjes së madhësisë së borxhit. Sa kapacitete dhe fuqi ka një ekonomi për të ripaguar? Nëse me gjendjen aktuale një qeveri s'e garanton dot atë ripagesë, ajo është e detyruar të grumbullojë më shumë para. Grumbullimi i më shumë parave do të thotë taksat më të larta, pasi mënyra kryesore që qeveria të

Vendosja e disiplinës financiare në pagesën e të gjitha faturave të lëshuara në kohë, mosfillimi i investimeve që nuk mbështeten me fonde në buxhet, monitorimi i rreptë i shpenzimeve buxhetore, moskryerja e investimeve përtej mundësive të të ardhurave, kontrolli në ripagimet e detyrimeve të mbartura etj, janë masa që po parashikohen me qëllim të një sjelljeje dhe qasjeje të re ndaj financave publike.

mbledhë të ardhura, është nëpërmjet sistemit të taksave. Borxh më i lartë nënkupton taksat më të larta. Ripagimi nuk është më në dorën e huamarrësit, në kuptimin që të paguajë tani apo ta paguajë më vonë. Borxhi është detyrim dhe mospagesa e detyrimit ka pasoja të rënda për një vend. Çdo qeveri kërkon pajtë të shmangë masat shtrënguese ndërkombëtare dhe është e prirur të negociojë me huadhënësit për zgjidhje të pranueshme. Por borxhi nuk fshihet. Ai mund të ristrukturohet me pajtimin e dy palëve. Kjo do të thotë se me huadhënësit nuk mund të bësh rolin e të fortit dhe as të mos njohjes dhe injorimit. Historia ka shembuj, sidomos në periudha të kalimit të pushtetit në duar diktatorësh, të refuzimit dhe mosnjohjes së borxhit. Por kjo është e përkohshme, sepse me të ndërruar sistemi, gjëja e parë që negociohet, janë borxhet e vjetra.

Drejtimi i borxhit publik kërkon sjellje të kujdesshme dhe të përgjegjshme ndaj financave publike. Zhvillimi i ekonomisë duke marrë borxh nuk është një opsion i dhënë për gratis. Vendet që kanë marrë borxh pa kufi në emër të kryerjes së investimeve dhe të mungesës së kthimeve nga këto investime që do të ndikonin në ripagimin e borxhit, nuk përfaqësojnë histori suksesi. Ato janë zhytur në vështirësi të mëdha, me paqëndrueshmëri të madhe financiare dhe politike, me situata inflacioniste dhe me kosto të lartë për ekonominë dhe shoqërinë në rivendosjen e

Zhvillimi i ekonomisë duke marrë borxh nuk është një opsion i dhënë për gratis. Vendet që kanë marrë borxh pa kufi në emër të kryerjes së investimeve dhe të mungesës së kthimeve nga këto investime që do të ndikonin në ripagimin e borxhit, nuk përfaqësojnë histori suksezi.



stabilitetit makroekonomik. Situata aktuale e Shqipërisë ka prirje drejt çbalancimeve makroekonomike dhe me rrezik në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Zhvillimi i pretenduar në vitet e kaluara, duke u bazuar në rritjen e borxhit i ka bërë shumë të ndjeshme çekuilibrimet makroekonomike. Në emër të zhvillimit të infrastrukturës me argumentin se investimet do të shlyhen nga të ardhurat e rritura, janë harxhuar para të pastudiuara. Borxhi publik pritet të arrijë në nivelin 69 për qind për vitin 2013 ose rreth 936 miliardë lekë. Dobësimi i disiplinës fiskale nëpërmjet heqjes së të vetmit instrument mbrojtës, siç ishte tavani prej 60 për qind, aq sa është vendosur për vendet anëtare të BE-së, dobëson disiplinën për financat publike.

Shpesh borxhi real fshihet nga mosraportimi i shifrave të sakta. Në vende me infrastrukturë të dobët dhe të pazhvilluar, manipulimi dhe loja me shifrat është e pranishme. Për shembull, në rastin e vendit tonë, vetëm mosdeklarimi i detyrimeve që qeveria i ka biznesit për punët e kryera dhe të papaguara, për mosrimbursim të TVSH-së dhe të tatim-fitimit të parapaguar, e rrit borxhin me mbi 4%. Ka dhe detyrime të tjera, të cilat vetëm përmenden, por nuk janë certifikuar, si: vendimet gjyqësore, detyrimet ndaj ish-pronarëve dhe ish të dënuarve politikë, detyrimet e ndërmarrjeve shtetërore etj. Në ekonomi është krijuar një zinxhir mospagimesh dhe fenomene të ekonomisë *barter* janë shfaqur për shkak të mungesës së likuiditetit. Situatat e mbingopura me borxh duhen trajtuar me

profesionalizëm dhe me sakrificë. Në rast se treguesi i borxhit konsiderohet i lartë për fuqinë ekonomike të vendit dhe normat e rritjes së PBB-së nuk garantojnë ripagimin e detyrimeve, shkurtimi i shpenzimeve qeveritare është pjesë e një regjimi të shtrëngimit ekonomik, ku edhe sistemi i taksave ndryshon me qëllim që të kontribuojë për të rritur të ardhurat. Masat më të ashpra në një shtrëngim ekonomik janë uljet në paga dhe shkurtimet e vendeve të punës. Kjo është situatë e padëshiruar, por e pashmangshme. Zgjidhja për të paguar borxhin nëpërmjet printimit të monedhës është më problematike sesa pranimi i dështimit (falimentimit).

Zgjidhja e uljes së borxhit nuk arrihet me masa monetare. Politika fiskale është e rëndësishme, sepse shkurton shpenzimet e tepërta, zgjeron hapësirën fiskale për rritjen e të ardhurave, por sërish nuk mjafton. Vetëm rritja ekonomike e garanton uljen e borxhit. Nëse do analizojmë të dy treguesit e llogaritjes së borxhit publik (numëruesin e thyesës të përfaqësuar nga treguesi i huamarrjes dhe emëruesin të përfaqësuar nga treguesi PBB), vëmë re që ky tregues është në lidhje të anasjelltë me PBB. Një rritje e PBB, në kushte të tjera ta pandryshuara, e zvogëlon treguesin e borxhit. Zvogëlimi i huamarrjes (d.m.th.: ulja e deficitit buxhetor) do të ndikonte gjithashtu pozitivisht në uljen e këtij treguesi, por është e vështirë të arrihet në afatmesëm ulja e treguesit të huamarrjes në atë masë që të ndikojë në uljen e treguesit të borxhit. Kështu, është e këshillueshme nxitja e rritjes ekonomike, pasi

vetëm kjo krijon stabilitet, nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të punës dhe zgjerimit të bazës së të ardhurave të taksueshme. Politika fiskale në këtë rast ka rol të pazëvendësueshëm në nxitjen e ekonomisë, nëpërmjet stimujve që ajo injekton në sektorë të caktuar. Regjimi i shtrëngimit ekonomik është i përkohshëm, zakonisht zgjat për një periudhë afatmesme derisa ekonomia gjallërohet, por garanton rivendosjen e ekuilibrit makroekonomik. Aktualisht, në një regjim shtrëngimi ekonomik është Greqia. Në dallim me rastin e Greqisë, Shqipëria negocioi me FMN-në një marrëveshje fleksible trevjeçare, që pritet të miratohet nga bordi përkatës në muajt janar-shkurt 2014. Sipas një marrëveshjeje fleksibël, drejtimi i borxhit bëhet duke zhvilluar metoda të reja dhe ka për qëllim ndalimin e dështimit (falimentimit), si dhe është parandaluese e përkeqësimit të situatës drejt një falimentimi.

Por, pavarësisht regjimit që zbatohet për vendosjen e borxhit publik nën kontroll, e rëndësishme është që mësimit që nxirren nga një situatë të mos përsëriten dhe një praktikë e re të fillojë të zbatohet. Në rastin e vendit tonë, vendosja e disiplinës financiare në pagesën e të gjitha faturave të lëshuara në kohë, mosfillimi i investimeve që nuk mbështeten me fonde në buxhet, monitorimi i rreptë i shpenzimeve buxhetore, moskryerja e investimeve përtej mundësive të të ardhurave, kontrolli në ripagimet e detyrimeve të mbartura etj., janë masa që po parashikohen me qëllim të një sjelljeje dhe qasjeje të re ndaj financave publike.

BORXHI - NJE REALITET I KUDONDODHUR

Gjithçka është futur në një rreth vicioz, ku borxhet nuk po zgjidhin asgjë, thjesht po shtyjnë ditët. Ekzistojnë teori në ekonomi, sipas të cilave “mund të merret borxh për investime që kthehen mbrapsht dhe garantojnë zhvillim”, por ky nuk është rasti i Shqipërisë.

nga Zj. Aurora SULÇE

Mediat kanë shkruar pa fund për borxhin në dy vitet e fundit. Madje, mund të thuhet pa frikë se borxhi ka qenë fjala më e lakuar në hapësirën ekonomike të edicioneve informative apo faqeve ekonomike në gazeta. Në nëntor të vitit 2012, ish-qeveria Berisha hoqi kufirin ligjor të borxhit prej 60% të PBB-së, një veprim që inkurajoi rritjen e mëtejshme të këtij treguesi. Opozita e atëhershme, tashmë në pushtet, u zotua për ulje të borxhit, por tashmë kjo jo vetëm është e pamundur, por rruga e vetme për të nxjerrë financat publike dhe ekonominë nga kriza mbetet sërish borxhi. Përveç rritjes së borxhit me 22 miliardë lekë, e parashikuar kjo në aktin normativ për rishikimin e buxhetit të këtij viti, qeveria e re, sapo ka negociuar për një borxh të ri prej 300 milionë dollarë me FMN-në dhe një huaje prej 350 milionë dollarë me Bankën Botërore, marrëveshje këto që do të zyrtarizohen në janar.

Nëse zbresim më poshtë, shohim se bizneset nuk janë më mirë. Ato janë zhytur në borxhe te bankat, pasi qeveria e mëparshme nuk u ka dhënë paratë për punët publike që kanë kryer, me borxhe te partnerët e tyre, me borxhe te punëtorët për paga të pashlyera. Nëse do të shohim qytetarët, situata bëhet edhe më e dhimbshme. Huave të bankave iu janë shtuar borxhet te të afërmit dhe miqtë, madje borxhe po merren edhe për t'u ushqyer, me lista në dyqanet e vogla të lagjes. Kjo rezultoi në anketën e fundit të realizuar nga Banka e Shqipërisë, ku nga 1,210 familje të pyetura në të gjithë vendin, 33% e tyre kishin borxh dhe një pjesë e tyre, për konsum. Në borxhe me shumë shifra janë edhe shoqëritë në sektorin e energjisë, si: KESH dhe CEZ Shpërndarje; me borxhe deri në fyt

janë dhe shoqëritë e tjera publike, si: ujësjellësit. Gjithçka është futur në një rreth vicioz, ku borxhet nuk po zgjidhin asgjë, thjesht po shtyjnë ditët. Ekzistojnë teori në ekonomi, sipas të cilave “mund të merret borxh për investime që kthehen mbrapsht dhe garantojnë zhvillim”. Ky sigurisht nuk është rasti i Shqipërisë. Kombinimi i një niveli borxhi që mendohet të kapërcejë 72% të PBB-së, me një rritje ekonomike që këtë vit nuk do të jetë më e lartë se 1.3%, vetëm për zhvillim nuk flet, përkundrazi e kthen vendin në një ndërmarrje me humbje (për 2014-ën rritja pritet të jetë 2.1%). Për çdo lek të marrë borxh, ne paguajmë mesatarisht 6% interes, e barabartë kjo me rreth 3.6% të PBB-së. Kjo do të thotë se rritja ekonomike nuk shkon për mirëqenie e zhvillim, por shlyerje të interesave të borxhit.

Çfarë do të ndodhë dhe çfarë duhet të bëjmë? Zgjidhja e vetme mbetet sërish borxhi; një borxh i ri për


të shlyer një borxh të vjetër, një teori e njohur kjo në ekonomi dhe e frytshme, kur borxhi i ri merret me interesa më të ulëta se ai që paguan aktualisht. Një borxh i tillë u negociua me FMN-në dhe Bankën Botërore, por në të gjitha rastet kostot do të jenë aty dhe padyshim, do t'i vuajë qeveria e re dhe pashmangshmërisht, të gjithë ne dhe brezat që do të vijnë. Këto janë kosto jo vetëm ekonomike, por edhe politike, pasi do të rritet trysnia mbi politikat fiskale dhe buxhetore që duhet të ndiqen. A është kjo rruga më e drejtë? Tashmë nuk ka më kohë për refleksione të tilla, pasi fatkeqësisht, kjo është rruga e vetme.

Për sa i përket qytetarëve, ata duhet sërish të presin, derisa borxhi i ri i qeverisë të krijojë një valvule shkarkimi në ekonomi. Çështja thelbësore qëndron te fakti se sa shpejt këto efekte do të ndihen në jetën e përditshme dhe pashmangshmërisht brenda sistemit financiar shqiptar!



CREDINS  online

FALAS!



 04 22 34 096  www.bankcredins.com

Credins Online është shërbimi nëpërmjet internetit që ju mundëson kryerjen e shërbimeve bankare pa qenë nevoja të jeni prezent në bankë, mjafton të keni një kompjuter, celular smartphone apo tablet.

Me Credins online ju:

- ▶ Vështroni gjendjen e llogarive tuaja.
- ▶ Merrni informacione të detajuara, përmbledhje apo historikun e lëvizjeve të llogarive, kredive, depozitave apo kartave tuaja.
- ▶ Kryeni transfertat brenda dhe jashtë bankës.
- ▶ Kryeni transfertat brenda dhe jashtë Shqipërisë.
- ▶ Kryeni pagesa të faturave utilitare si energji elektrike, ujësjellës, apo pagesa qiraje etj..
- ▶ Kryeni këmbime valutore shitje/blerje në monedha të ndryshme.

Ejani në një nga degët tona dhe aplikoni për shërbimin Credins Online.

 **CREDINS bank**

**CREDINS ONLINE
PËRFITOHET
SHUMË THJESHT
DHE PA ASNJË
KOSTO
REGJISTRIMI.**



Z. Silvio PEDRAZZI,
Drejtor i Përgjithshëm
Intesa Sanpaolo Bank - Albania

INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA – MBËSHTETEMI FORT NË SHQIPËRI

Intesa Sanpaolo Group është padyshim një nga grupet më solide, likuide dhe më të balancuara bankare në Eurozonë, e për më tepër që marrëdhëniet mes Italisë dhe Shqipërisë janë të nivelit strategjik. Qëllimi ynë është mjaft i qartë: ne do të vazhdojmë të zhvillojmë të dy segmentet: si të biznesit dhe të individëve, duke konsoliduar dhe përmirësuar pozicionin tonë.

BANKIERI: PARA SË GJITHASH, NJË URIM PËR POZICIONIN TUAJ TË RI NË BANKË. CILAT JANË PËRSHTYPJET TUAJA TË PARA PËR SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR, LIDHUR ME ZHVILLIMIN, KONKURRENCËN DHE PRODUKTET BANKARE?

Ju falenderoj për urimet dhe jam shumë i kënaqur e i nderuar që do të shërbej si Drejtor i Përgjithshëm i Intesa Sanpaolo Bank - Albania. Përshtypja e parë është mjaft pozitive, pavarësisht nga fakti që industria bankare, në përgjithësi, po përballet me një periudhë të mbushur me plot sfida në të gjitha vendet. Sa i përket realitetit shqiptar, gjithkush mund të vërejë dritëhijet me të cilat ai paraqitet. Nëse nga njëra anë sistemi është tejet i mirëkapitalizuar dhe likuid, nga ana tjetër, niveli i përfitueshmërisë është padyshim i ulët dhe po përkeqësohet, kryesisht për shkak të cilësisë jo të kënaqshme të aktiveve. Natyrisht që bankat, si dhe industrinë e tjera, po vuajnë shtrëngesat e një mjedisi ekonomik në stanjacion, por unë besoj se ekonomia së shpejti do të fillojë gjallërimin. Në këto rrethana, duke pasur parasysh dhe nivelin tejet të ulët të normave të interesit, konkurrenca do vijojë të rritet, ku faktorët kyç të suksesit do të jenë aftësia për të optimizuar kostot, qasja e një menaxhimi efektiv të rreziqeve, si dhe cilësia e burimeve njerëzore. Për sa i përket biznesit, kujdesi ndaj klientit, që nënkupton aftësinë për të trajtuar dhe përmbushur nevojat e klientëve si dhe transparenca e propozimeve të biznesit, do të përbëjë ndryshimin më të madh mes bankave.

BANKIERI: SI NJË NGA GRUPET KRYESORE BANKARE NË ITALI DHE NË KUADËR TË NDRYSHIMEVE TË MËDHA RREGULLATORE NË EUROZONË, A KA NDOJË NDRYSHIM, PËR VITET NË VIJIM, NË STRATEGJINË E BIZNESIT TË BANKËS NË SHQIPËRI?

Intesa Sanpaolo Group është padyshim një nga grupi më solide, likuide e më të balancuara bankare në Eurozonë, e

për më tepër që marrëdhëniet mes Italisë dhe Shqipërisë janë të nivelit strategjik. Qëllimi ynë është mjaft i qartë: ne do të vazhdojmë të zhvillojmë të dy segmentet: si të biznesit dhe të individëve, duke konsoliduar dhe përmirësuar pozicionin tonë.

BANKIERI: A MUND TË PËRMENDNI DISA NGA ARRITJET KRYESORE TË BANKËS PËR VITIN 2013, SI DHE DISA NGA PRIORITETET KYÇE, PËR VITIN 2014?

Gjatë vitit të fundit Intesa Sanpaolo Bank - Albania arriti rezultate të shkëlqyera, duke vënë në jetë disa projekte, që kanë për qëllim vendosjen e piketave për zhvillimet e mëtejshme të biznesit të saj. Ndër të tjera, mund të përmenden zbatimi i mekanizmave të sofistikuar për menaxhimin e rreziqeve, zbatimi i një serie të plotë politikash me orientim drejt klientit, si dhe sistemi i fortë dhe efektiv i menaxhimit të kostove.

Për sa i përket vitit në vijim, banka ka planifikuar kryerjen e disa investimeve të rëndësishme, si dhe ka filluar modernizimin e sistemit të IT-së, që do t'i mundësojë bankës t'u ofrojë klientëve të saj teknologjinë e lëvizshme më të përparuar. Përveç kësaj, ne do të hedhim në treg disa produkte të reja që përbëjnë risi për tregun, duke synuar plotësimin e nevojave të klientëve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet segmenteve që gjykojnë strategjike nga ne për ekonominë kombëtare, duke përfshirë bujqësinë, turizmin, prodhimin, sikurse dhe prodhimin e energjisë; NMV-të do të shohin një qëndrim të ri të bankës ndaj biznesit të tyre. Sigurisht, edhe për individët do të ketë së shpejti produkte të reja.

BANKIERI: CILI ËSHTË TIPARI MË DALLUES I INTESA SANPAOLO BANK - ALBANIA?

Aftësia me klientët, transparenca, paanshmëria, shpejtësia dhe teknologjia.

PLATFORMA E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR TRAJTIMIN E HUAVE ME PROBLEME – NJË QASJE E RE



nga Z. Gerond ZIU
Përgjegjës i Zyrës së Mbikëqyrjes
së Bankave Sistematike
Departamenti i Mbikëqyrjes,
Banka e Shqipërisë

Ndër problemet me të cilat përballlet sot ekonomia shqiptare është dukuria e huave me probleme, e cila ka ardhur në rritje që nga viti 2008. Banka e Shqipërisë e ka shfaqur që në fillim të herës shqetësimin për shfaqjen e këtij fenomeni dhe ka paralajmëruar bankat për të marrë masat e nevojshme paraprake, për t'i paraprirë kësaj dukurie, që mund të përmblihdhen në: rritjen e cilësisë së menaxhimit të rreziqeve, krijimin e strukturave të përshtatshme, kryerjen në kohë dhe në mënyrë të shëndetshme të ristrukturimeve të huave, kryerjen e analizave së provës së rezistencës (*stress-test*) dhe rritjen e burimeve kapitale, në përputhje me rezultatet e analizave. Këto janë shoqëruar edhe me ndërhyrjet përkatëse ligjore e rregullative për trajtimin e hershëm të këtij fenomeni, si për bankat ashtu edhe për institucionet e tjera, ndër të cilat mund të përmendim, si më të rëndësishëm, ndryshimin e ligjit për bankat, ndryshimin e rregullores: “Për administrimin e rrezikut të huas”, apo lehtësimin e kërkesave rregullative për ristrukturimin e huave.

Çështja e ristrukturimit të huave ka një vëmendje konstante të Bankës së Shqipërisë dhe së fundmi, përveç ndryshimeve lehtësuese rregullative të bëra në fillim të vitit, do të gjejë një vëmendje të mëtejshme me nismën e fundit të prezantimit të kësaj platforme.

Megjithatë, treguesi i lartë i huave me probleme ka treguar se faktorë të rëndësishëm që mund të ndikojnë në zbutjen e kësaj dukurie, nuk kanë funksionuar me të gjithë hapësirat e mundshme lehtësuese. Vështirësitë e ndeshura në procesin e ekzekutimit të kolateraleve nuk kanë ndihmuar mjaftueshëm në dhënien e mesazheve të duhura për përgjegjësitë që kanë operatorët ekonomikë e individualë për shlyerjen e detyrimeve të tyre ndaj bankave. Ndërkohë që duhej të konstatohej se fenomeni i fshirjes së huave me probleme nga bilancet e bankave, që në asnjë rast nuk nënkupton shmangien e përgjegjësisë të huamarrësve për shlyerjen e detyrimeve të tyre, nuk është bërë në nivel të mjaftueshëm. Edhe hapësirat ligjore fiskale kanë ndikuar negativisht në stepjen e bankave, në drejtim të fshirjes së huave për shkak të hapësirave të interpretimit që krijohen. Për këtë arsye mund të thuhet që treguesi i huave me probleme nuk paraqet gjendjen reale të cilësisë së huave nën ndikimin e faktorëve deformues. Ristrukturimi i huave është një ngjarje, pritshmëria për të cilën është lehtësimi i aftësive paguese të huamarrësve, si dhe një frymëmarrje më e gjerë e ekonomisë së vendit në tërësi.

Nismat për ndryshime ligjore e rregullative kanë qenë të lidhura pikërisht me uljen e nivelit të huave me probleme, nëpërmjet krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për rritjen e ndikimit, në kahun pozitiv. Ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Civile kishin si qëllim rritjen e efikasitetit të procesit të ekzekutimit të kolateraleve, si në drejtimin e uljes

së burokracive, ashtu edhe në drejtim të lehtësimit të kushteve të likuidimit të pronave të lëna, si: kolateral, duke gjetur një përputhje më të madhe me ofertat e tregut. Ndryshimet e bëra në Udhëzimin e ministrit të Financave për saktësimin e kuptimit të borxhit të keq për institucionet financiare, pritjet të lehtësojë procesin e fshirjes së huave dhe uljen e nivelit të artificialitetit të treguesit të huave me probleme. Paketa e masave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në fillim të këtij viti, nëpërmjet lehtësimit të kërkesave rregullative për nxitjen e huadhënies në vend, synon të japë stimuj pozitivë në mjedisin ekonomik dhe atë financiar, të paktën deri në fund të vitit 2014. Ndryshimet rregullative të Bankës së Shqipërisë për lehtësimin e kriterëve rregullative, në drejtim të klasifikimit dhe provigjio-

Qëllimi i kësaj platforme është analiza dhe trajtimi i huamarrësve me probleme, ose që kanë filluar të shfaqin probleme në portofolet individuale të bankave. Si hap i parë i zbatimit të platformës është kërkuar raportimi nga ana e bankave të të gjitha huave të dhëna për biznes, përveç atyre të klasifikuara si “standarde”.

nimit të huave të ristrukturuara, kanë krijuar gjithashtu kushte të përshtatshme për nxitjen e këtij procesi. Në mbështetje të tij vijnë edhe publikimi nga Banka e Shqipërisë i dy udhëzuesve për ristrukturimin e huave, një për biznesin dhe një për individët, të cilët synojnë të orientojnë palët që hyjnë në një marrëdhënie ristrukturimi. Nëpërmjet mesazheve të vazhdueshme të Bankës së Shqipërisë, që me shfaqjen e krizës financiare ndërkombëtare, është synuar të rritet ndërgjegjësimi i sistemit bankar për kryerjen e hershme të ristrukturimeve të huave, si një ndër instrumentet më të rëndësishëm për të ndihmuar në vazhdimësinë e veprimtarisë së biznesit dhe asaj ekonomike në tërësi. Praktika të ngjashme janë ato të ndjekura nga shtete që janë ndeshur me kriza të forta financiare dhe që kanë ndërmarrë ristrukturime në shkallë të gjerë ekonomie, për të cilat më përfaqësueset janë rastet e Anglisë, të Koresë së Jugut dhe të Turqisë.

Çështja e ristrukturimit të huave ka një vëmendje konstante të Bankës së Shqipërisë dhe së fundmi, përveç ndryshimeve lehtësuese rregullative të bëra në fillim të vitit, do të gjejë një vëmendje të mëtejshme me nismën e fundit të prezantimit të platformës së trajtimit të huave me probleme. Kjo platformë është hartuar nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën Këshilluese të Sektorit Financiar (FinSAC) me qendër në Vjenë. Kjo qendër është themeluar nga Banka Botërore dhe ka për qëllim të ofrojë asistencë teknike për çështje të re-

gullimit dhe të mbikëqyrjes së sektorit financiar, për bankat qendrore dhe rregullatorët financiarë në Europë dhe në Azinë Qendrore. Për zbatimin e kësaj platforme, FinSAC do të asistojë, nëpërmjet shërbimeve të një kompanie të specializuar dhe me eksperiencë ndërkombëtare, përfshirë rajonin në të cilin ndodhet Shqipëria.

Qëllimi i kësaj platforme është analiza dhe trajtimi i huamarrësve me probleme, ose që kanë filluar të shfaqin probleme në portofolet individuale të bankave. Si hap i parë i zbatimit të platformës është kërkuar raportimi nga ana e bankave të të gjitha huave të dhëna për biznes, përveç atyre të klasifikuara, si: “standarde” (sipas përcaktimeve të rregullores: “Për administrimin e rrezikut të huas”). Kërkesat për raportim, përveç të dhënave të përgjithshme të ekspozimit ndaj huamarrësit, përfshijnë edhe kërkesat për të dhëna financiare të tij për tre vitet e fundit, si dhe për kolateralet e lëna peng. Nga kjo listë e raportuar, do të përzgjidhen një numër i caktuar i huamarrësve, për të cilët do të analizohen individualisht mundësitë dhe hapësirat e rikuperimit. Përzgjedhja do të bëhet duke marrë në konsideratë një sërë faktorësh, si: madhësia e huas, sektori ekonomik ku operon, vendndodhja gjeografike, niveli i ekspozimit në sistem etj. Qëllimi është që të bëhet një përzgjedhje sa më përfaqësuese në nivel sistemi, si në aspektin cilësor ashtu edhe atë sasior, në mënyrë që ndikimi i rezultateve të jetë sa më i gjerë jo vetëm për bankat, por edhe

Për secilin prej huamarrësve të përzgjedhur do të kërkohej që bankat të përgatisin planet e rikuperimit të këtyre huamarrësve. Paralelisht, do të bëhet një analizë të detajuar e mundësisë dhe hapësirave të rikuperimit të tyre, me ndihmën e shoqërisë së konsulencës, nëpërmjet metodologjisë së përdorur prej saj.

për ekonominë e vendit.

Për secilin prej huamarrësve të përzgjedhur do të kërkohej që bankat të përgatisin planet e rikuperimit të këtyre huamarrësve. Paralelisht, do të bëhet një analizë të detajuar e mundësisë dhe hapësirave të rikuperimit të tyre, me ndihmën e shoqërisë së konsulencës, nëpërmjet metodologjisë së përdorur prej saj. Rezultatet e këtyre analizave do të ballafaqohen me ato të bankave dhe do të diskutohen me to për të arritur në një zgjidhje të përshtatshme dhe të qëndrueshme, si për huamarrësit ashtu edhe për bankat. Në këtë mënyrë, do të krijohet mundësia që jo vetëm të zgjerohen opsionet e zgjidhjeve të përshtatshme të vështirësive të huamarrësve, por edhe të zbatohen ato edhe në nivel të të gjithë portofolit, si dhe të krijohet një bazë e mirë eksperiencë edhe për të ardhmen.

Për t'i dhënë tipar më të qëndrueshëm këtij ushtrimi dhe për të pasur një përfshirje të plotë të të gjitha bankave, rezultatet e ushtrimit do të analizohen më tej për të vlerësuar mundësinë e ndërhyrjes me politika të mëtejshme në treg. Si element fillestar i identifikuar në këtë drejtim është ai i vendosjes së kërkesave rregullative për një prani më të madhe të Këshillave Drejtues të bankave në analizën dhe monitorimin e huamarrësve të mëdhenj, si dhe në hartimin dhe rishikimin e herëpashershëm të planeve të rikuperimit të këtyre huamarrësve. Hapësirat e mëtejshme që do të identifikohen për ndryshimet rregullative, si dhe mënyrat e zbatimit të tyre do të diskutohen gjerësisht me të gjitha bankat.



CBA

CREDIT BANK OF ALBANIA

BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE

OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, Ilogari rrjedhëse dhe me afat, transferta parash, garanci bankare, shkëmbime dhe të gjitha shërbimet tradicionale bankare.

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative " AL-KHARAFI
(pranë Fuktetit Juridik)
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 272168/66; Fax +355 42 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

Sheraton Tirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 42 2255372/388/368/346
Fax: +355 42 255340

Hotel "Butrinti" Sarandë
Tel: +355 85 225405

ÇATIA E SIGURISË



nga Z. Roland TASHI
Kryetar, Komiteti i AAB-së
për Sigurinë Bankare

Shqipëria, krahasuar me vendet e tjera të rajonit, hyri me vonesë në rrugën e zhvillimit kapitalist. Kjo dhe nxitimi për të prekur “produktin” e sistemit të ri shoqëror, kërkoi midis shumë ndryshimeve sociale dhe ekonomike një rikonceptim të konceptit të sigurisë, të sigurisë kombëtare dhe asaj publike, krijimin e koncepteve të reja për sigurinë njerëzore, sigurisë së bizneseve dhe sidomos sigurisë së bankës qendrore, sistemit bankar e atij financiar, që gradualisht filloi të formohej dhe të hynte në rrugën e zhvillimit kapitalist.

Siguria në sistemin bankar dhe atë financiar, sistem që filloi të strukturohej jo vetëm nga biznesi vendas, por edhe nga ai i huaj, duhet të përbënte kryefjalën dhe garancinë për një funksionim normal të këtij sistemi, për të shmangur krijimin e precedentëve për cënim të sigurisë dhe krijimin e shqetësimeve si dhe trazirave sociale. Vëmendja e pamjaftueshme në drejtim të bankave, jo vetëm në drejtim të mbrojtjes dhe sigurisë fizike të tyre, u pasua me ngjarje realisht dramatike gjatë gjysmës së parë të viteve '90, gjatë viteve të lulëzimit të

Siguria duhet konsideruar si “produkt” i veprimtarisë dhe angazhimit të strukturave të sigurisë, lidershit, aktorëve dhe operatorëve të interesuar e të certifikuar, si çati që do të mbrojë dhe garantojë kushte normale pune dhe biznesi për sistemin bankar.


firmave piramidale, që e përfunduan ciklin në vitin 1997 me pasoja gati të një lufte.

Siguria duhet konsideruar si “produkt” i veprimtarisë dhe angazhimit të strukturave të sigurisë, lidershit, aktorëve dhe operatorëve të interesuar e të certifikuar, si çati që do të mbrojë dhe garantojë kushte normale pune dhe biznesi për sistemin bankar. Më pas, ky “produkt” i përfutur do të shërbejë si e mirë publike, që e përftojnë jo vetëm ata që punojnë dhe kanë marrëdhënie me bankën, por një publik edhe më i gjerë. Natyrshëm lind pyetja, si duhet të qëndrojë “çatia e sigurisë”, cilat duhet të jenë shtyllat mbajtëse, në mënyrë që së pari ajo të ekzistojë e më pas, të jetë efiçiente, mbrojtëse dhe e qëndrueshme? Fillimisht duhet të kuptohet se të gjitha bizneset, në veçanti ato financiare, ku produkti përbëhet nga paraja, e në këtë kontekst ato janë më të goditurat nga krimi dhe veprimet e brendshme abuzive, duhet të kenë koncepte shumë të qarta për sigurinë. Veprimtaria e tyre nuk mund të fillojë pa ngritur më parë njësinë përkatëse, që do të ideojë dhe zbatojë të gjithë sistemin mbrojtës për garantimin e zhvillimit normal të veprimtarisë.

Shtylla e parë mbajtëse lidhet me funksionimin në pemën organizative të bankës, bizneseve të tjera financiare, të një strukture të veçantë, që kryhen detyra vetëm në drejtim të sigurisë. Pavarësisht se kjo kushtëzohet dhe në rregulloren përkatëse të Bankës së Shqipërisë, disa banka nuk

kanë të emërtuara njësi, apo specialistë të veçantë për sigurinë. Ndjekja e detyrave të sigurisë dhe mbrojtjes, i kalohet punonjësve që kryejnë edhe detyra të tjera, kryesisht të fushës administrative. Detyra kryesore e kësaj “shtylle” duhet të jetë: parashikimi (reduktimi i mundësive) dhe mbrojtja (reduktimi i pasojave). Eksperienca e një specialisti, profesionisti të sigurisë, ka një rol të rëndësishëm sidomos në parashikimin, vlerësimin

Fillimisht duhet të kuptohet se të gjitha bizneset, në veçanti ato financiare, ku produkti përbëhet nga paraja, e në këtë kontekst ato janë më të goditurat nga krimi dhe veprimet e brendshme abuzive, duhet të kenë koncepte shumë të qarta për sigurinë, veprimtaria e tyre nuk mund të fillojë pa ngritur më parë njësinë përkatëse, që do të ideojë dhe zbatojë të gjithë sistemin mbrojtës për garantimin e zhvillimit normal të veprimtarisë.



dhe interpretimin në bankë, Shoqëri tregtare apo organizatë të situatave specifike. Përkundrazi, mungesa e tij ndikon në rritjen e nivelit të ekspozimit ndaj rrezikut dhe shtimin e kostove ekonomike për reduktimin e pasojave. Një nga pasojat ndikuese në biznes është dhe do të mbetet edhe rreziku reputacional, që përveç kostove ekonomike, ndikon në besueshmërinë e publikut, sidomos ndaj biznesit bankar, ku ndjeshmëria dhe vëmendja është edhe më e madhe.

Shtylla e dytë është baza ligjore dhe rregullative. Strukturat e sigurisë duhet të vepronin vetëm mbi baza ligjore, mbi praktika dhe akte administrative të miratuara nga lidhshipi. Duhet vlerësuar fakti se strukturat e sigurisë, për vetë objektin dhe detyrat që kryejnë, kanë akses të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nëpërmjet sistemeve të mbrojtjes elektronike, telekamerave etj., në zona, procedura, praktika me ndjeshmëri dhe jetike për institucionin. Në këtë këndvështrim, në rast se veprimtaria e tyre nuk është “e disiplinuar” mbi një praktikë të plotë administrative, me autoritete dhe kompetenca të fragmentuara, shtohet mundësia që segmente të caktuara të këtyre strukturave të abuzojnë, të shtojnë ekspozimin në rrezik, duke dëmtuar institucionin.

Shtylla e tretë lidhet me organizimin dhe funksionimin e mbrojtjes fizike, mbrojtjes aktive të bankës,

nëpërmjet burimeve njerëzore, nëpërmjet shërbimeve të sigurisë që kryhen me punonjës të bankës apo punonjës të Shoqërive të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike (SHRSF). Pavarësisht se shtylla e tretë është në qendër të “çatisë së sigurisë”, si shtylla kryesore, ajo mbetet më e rrezikuara e më e ndjeshmja. Kjo, pasi individit në rolin e punonjësit të sigurisë, punonjësit që shërben në sportel, në rolin e operatorit, në rolin e transportuesit dhe shoqëruesit të vlerave monetare. Pra individit që përballlet drejtpërdrejt dhe fizikisht në një skenë krimi, është ai/ajo që do të marrë e do të mbartë ngarkesa psikofizike dhe psikosociale. Harmonizimi efikas i masave të mbrojtjes nëpërmjet burimeve njerëzore me masa të mbrojtjes dhe sigurisë teknike dhe elektronike, jo vetëm ndikon në rritjen e nivelit të eficiencës së shërbimit, por mbron dhe largon individin nga dëmtimet psikologjike.

Shtylla e katërt lidhet dhe funksionimin e sigurisë elektronike si dhe masave të tjera mbrojtëse, që projektohen të funksionojnë pa praninë e individit. Padyshim që edhe kjo është një shtyllë mbajtëse e rëndësishme, vështirë “e korrupsioneshme”, e cila sa më e sofistikuar të jetë, aq më shumë pengon aktet abuzive, të grabitjes e aq më shumë ndihmon strukturat e sigurisë që të rrisin nivelin e mbrojtjes të objektit dhe sidomos të burimeve njerëzore. “Mbrojtja elektronike”, thënë ndryshe mbrojtja

pasive, nëpërmjet pajisjeve dhe sistemeve teknologjike, funksionon “non stop”. Mbrojtja nëpërmjet sistemeve elektronike siguron biznesin, aktivet dhe paratë edhe gjatë pjesës tjetër të ditës, si dhe në ditët e pushimit, kur në institucion nuk ka shërbim me burime njerëzore. Duhet theksuar se, të dhënat që sigurohen dhe arkivohen nga sistemet e mbrojtjes elektronike, ku veçohen të dhënat e sistemeve televizive me qark të mbyllur, të dhënat e hyrjeve me akses të kontrolluar etj., në rastet e grabitjeve, vjedhjeve të brendshme dhe situatave të ndryshme abuzive, do të shërbejnë si prova e materiale referuese për ekspertët e kriminalistikës dhe agjencitë ligjzbatuese. Sistemet e mbrojtjes elektronike duhet të ndjekin zhvillimet teknologjike bashkëkohore, bankat dhe të gjitha institucionet e interesuara duhet të zbatojnë dhe instalojnë programe dhe sisteme të përparuara, që mundësojnë dhënie e detajeve për zbardhjen e një ngjarjeje abuzive apo skene krimi.

Shtylla e pestë është trajnimi i vazhdueshëm për çështjet e sigurisë dhe kujdesit në punë i të gjithë punonjësve të bankës, institucionit apo ndërmarrjes. Pavarësisht se trajnimi, formimi dhe informimi i punonjësve për të gjitha rreziqet që lidhen apo ndikohen nga vendi i tyre i punës, është kusht ligjor, ai duhet konsideruar “domosdoshmëri” dhe prioritet i politikave të biznesit të çdo niveli qofshin ato.

Bankat, në zbatim të kushteve të vendosura nga Banka e Shqipërisë, shërbimet e sigurisë fizike dhe shërbimet e transportit dhe shoqërimit të vlerave monetare, i përftojnë nga SHRSF-të. Mbetet shumë e rëndësishme që punonjësit e këtyre shoqërive, për vetë specifikën që kanë shërbimet në banka, të kenë trajnime periodike të veçanta, për mënyrën e kryerjes së shërbimit, mënyrën e reagimit dhe veprimit, në rast grabitje të bankës apo mjetit të blinduar që transporton vlera monetare dhe më e rëndësishmja, mënyrën dhe kohën e përdorimit të armëve të zjarrit. Shumë njësi biznesi bankare veprojnë në qendër të qyteteve, me frekuenca të madhe lëvizje të qytetarëve dhe automjeteve, përdorimi i armëve të zjarrit nga punonjës të patrajnuar do të shkaktonte probleme më të rënda se pasojat e një grabitjeje.

STABILIZIMI - KRYEFJALA PËR SEKTORIN FINANCIAR SHQIPTAR



nga Zj. Enkeleda SHEHI
Kryetare, Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare, AMF

Tashmë është fakt i mirënjohur që sistemi financiar përbën gurin e themelit në një ekonomi moderne. Në një mënyrë ose tjetër secili prej nesh është në kontakt të vazhdueshëm me sistemin financiar. Në ekonomitë në zhvillim, sistemi financiar ka gjithashtu rëndësi të veçantë, sepse ecuria dhe zhvillimi i tij ndikon gjerësisht në zhvillimin tërësor të ekonomisë. Një sektor financiar që është i shëndetshëm dhe modernizohet, kontribuon në shëndetin e ekonomisë së vendit. Ndërkohë, krizat financiare, sikurse e ka treguar historia e zhvillimit të tyre dhe siç e konfirmoi edhe kriza më e fundit financiare botërore, që nisi në vitet 2007-2008, kanë pasojat të rënda për ekonominë dhe popullsinë e një vendi, riparimi i të cilave kërkon nganjëherë vite të tëra për t'u realizuar dhe është proces mjaft i kushtueshëm. Për këtë arsye, synohet shmangia e ndodhjes së krizave ose marrja e masave të menjëhershme e të hershme, për të minimizuar pasojat e tyre, në rastet kur ato janë të pashmangshme. Mësimet e nxjerra nga krizat financiare, kanë bërë që të rritet theksi në procesin rregullues e mbikëqyrës të sektorit financiar, si dhe të përqendrohet vëmendja jo

vetëm në mbarëvajtjen e institucioneve financiare të marra veçmas, por në nxitjen e stabilitetit financiar të tregjeve në tërësi, rritjen e bashkërendimit të veprimeve të rregullatorëve në vend dhe përtej kufijve, si dhe forcimin e standardeve mbikëqyrëse e rregullatore në shkallë ndërkombëtare.

Nëse në momentin e parë, kur flasin për sektorin financiar dhe krizat në mendje kemi tregun bankar dhe krizat bankare, nuk janë më pak të rëndësishme edhe tregjet e tjera financiare, si: tregu i sigurimeve, ai i fondeve të pensioneve private apo i letrave me vlerë. Këto pjesë të sektorit financiar, nëse janë të zhvilluara mirë, shndërrohen në elementë të rëndësishëm të një sistemi financiar të

E gjithë strategjia për stabilizim do të vihet në jetë jo me përpjekje të izoluar nga AMF-ja, por në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera, në veçanti me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

AMF do të ndërmarrë një paketë masash për tregun financiar në periudhën afatmesme (2014-2016), që kanë për objektiv nxitjen e zhvillimit të tregjeve financiare, zgjerimin e gamës së produkteve financiare, edukimin dhe mbrojtjen e konsumatorit, mbështetjen e reformave financiare, si dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe të rregullimit të tregjeve.

efektshëm dhe të shëndetshëm. Ato shërbejnë si bazë solide për formimin e kapitalit, rritjen dhe prosperitetin e ekonomisë, nëpërmjet kontributit në zgjerimin dhe thellimin e sistemit financiar të një vendi. Operatorët në këto tregje financiare (shoqëritë e sigurimit të jetës dhe të jo jetës, fondet e pensioneve private vullnetare apo fondet e investimeve dhe ndërmjetësit e tjerë në to), me shërbimet e tyre shërbejnë si kanale shtesë për financimin e ekonomisë, rëndësia e të cilave rritet kur kanali i kreditimit është në ngërç; ofrojnë produkte kurrsimi afatgjata dhe të mbrojtjes nga rreziqet e tepërta, duke reduktuar problemet financiare e sociale në të ardhmen, si dhe kostot e tyre; apo shtojnë alternativat për investim nga popullata, duke ndihmuar në rritjen e mirëqenies së përgjithshme. Por që të përmbushen këto synime, e rëndësishme është që operatorët në tregjet financiare dhe në tërësi këto tregje të mirëadministrohen dhe të jenë të sigurt e të shëndetshëm.

Pavarësisht shkallës më të ulët të zhvillimit të sektorit financiar, të njëjtat konsiderata janë të vlefshme edhe për Shqipërinë. Për këtë arsye, kryefjala për sektorin financiar në një periudhë afatmesme do të jetë *stabilizimi* i tij. Çfarë nënkupton konkretisht Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), me *stabilizim të tregut*? Sigurisht që nuk nënkuptohet dhe aludohet aspak që aktualisht tregu financiar në



Online, dyert tona janë 24 orë të hapura.

E-banking nga Crédit Agricole! Përfitoni tani
0 Komision për regjistrimet e 6-mujorit të parë.



vend është i paqëndrueshëm, apo ka probleme në funksionim të operatorëve të veçantë, ose të marrë në tërësi. Përkundrazi, termin *stabilizim* AMF e përdor për të karakterizuar një paketë masash që do të ndërmerren nga AMF për tregun financiar në periudhën afatmesme (2014-2016), të cilat kanë për objektin nxitjen e zhvillimit të tregjeve financiare, zgjerimin e gamës së produkteve financiare, edukimin dhe mbrojtjen konsumatore, mbështetjen e reformave financiare, si dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe të rregullimit të tregjeve. Përmbushja e këtyre objektivave synon forcimin e stabilitetit në tregje, gjë që kontribuon në rritjen e stabilitetit ekonomik. Me fjalë të tjera, AMF do të ndërmarrë masa *stabilizuese*, për të siguruar *stabilitetin*.

Me fjalë të tjera, *stabilizimi* mbëshetet në këto shtylla kryesore:

1. Forcimi i pavarësisë së AMF-së, sidomos pavarësisë operacionale dhe financiare, si kusht i domosdoshëm për të përmirësuar efektivitetin e procesit rregullator e mbikëqyrës.
2. Mbrojtja e konsumatorëve, duke përcaktuar masa që të rritin shkallën e transparencës dhe thjeshtësisë së dhënies së informacionit nga institucionet financiare për klientët e tyre. Gjithashtu, mbrojtja e konsumatorëve synohet të sigurohet nëpërmjet *nxitjes së konkurrencës së shëndetshme* në tregun financiar, që nënkupton ofrimin e produkteve me kosto të arsyeshme për klientët, por pa çënuar apo rrezikuar vijueshmërinë e ofrimit të shërbimeve dhe të përfitimeve që pret të marrë një klient nga institucionet financiare, të tilla si: pagesat për dëmet nga shoqëritë e sigurimit, ofrimin e kthimit real nga investimet në fonde, apo përfitimin e pagesave të pensioneve nga fondet e pensioneve private.
3. Ushtrimi i mbikëqyrjes së konsoliduar, që nënkupton një fazë të re në procesin mbikëqyrës të institucioneve financiare dhe të ndërtimit të kompetencave mbikëqyrëse të AMF-së dhe Bankës së Shqipërisë në banka dhe fondet e investimeve. Kjo dikton një forcim të bashkëpunimit të derisotëm me qëllimin e mbikëqyrjes më efektive të rreziqeve të tregut e të likuiditetit.
4. Nxitja e zhvillimit të shtyllës së tretë të pensioneve dhe ndërtimi i shtyllës së dytë, si pjesë e reformës në fushën e pensioneve.



Mësimet e nxjerra nga krizat financiare, kanë bërë që të rritet theksi në procesin rregullues e mbikëqyrës të sektorit financiar, si dhe të përqendrohet vëmendja jo vetëm në mbarëvajtjen e institucioneve financiare të marra veçmas, por në nxitjen e stabilitetit financiar të tregjeve në tërësi, rritjen e bashkërendimit të veprimeve të rregullatorëve në vend dhe përtej kufijve, si dhe forcimin e standardeve mbikëqyrëse e rregullatore në shkallë ndërkombëtare.

Këto nënkuptojmë një reformim tërësor të skemave të pensioneve në vend, me qëllim që të administrohen rreziqet që rrjedhin prej ndryshimeve demografike në vend, si dhe për të ofruar mekanizma për ruajtjen dhe rritjen e mirëqenies së popullatës. Në këtë aspekt AMF-ja ka një rol të rëndësishëm, që nënkupton forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, për të siguruar mbikëqyrje të kujdesshme të fondeve të pensioneve dhe qëndrueshmëri të tyre.

5. Përmirësimi i funksionimit të tregut të sigurimeve nëpërmjet vendosjes së standardeve të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, likuiditetin,

zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku, apo të marrjes së masave me ndikim afatgjatë, të tilla si: zhvillimi i programeve për sigurimin e përgjegjësive të shërbimeve të ndryshme apo të rreziqeve nga ngjarjet e natyrës së katastrofave.

Sigurisht që e gjithë strategjia për *stabilizim* do të vihet në jetë jo me përpjekje të izoluar nga AMF-ja, por në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera, në veçanti me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar. *Stabilizimi* përbën kryefjalën e sektorit financiar, sepse në fund të fundit është në interesin e çdo qytetari në Shqipëri.

SISTEMI SHQIPTAR I GARANCIVE, NËN DRITËN E NDRYSHIMEVE TË FUNDIT

Në praktikë, perfeksionimi efektiv dhe/ose ekzekutimi i pengut të vendosur sipas dispozitave të Kodit Civil mbi pasuritë e paprekshme është shumë i diskutueshëm.

nga **Z. Sokol ELMAZAJ**
Partner, BOGA & ASSOCIATES



Zj. Sabina LALAJ
Avokate, BOGA & ASSOCIATES

Gjatë vitit 2013 ndodhën disa ndryshime të rëndësishme në legjislacionin që lidhet me sistemin e garancive, kolateralin financiar dhe pagesave.

1. Kolaterali financiar

Në gjysmën e parë të vitit 2013, Kuvendi miratoi ligjin "Për sistemin e pagesave" (nr. 133/2013), i cili hyri në fuqi më 29 maj 2013. Ky ligj, midis të tjerash, prezantoi kolateralin financiar, në përputhje me Direktivën 98/26/KE (e ndryshuar) të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 19 maj 1998 "Mbi finalizimin e shlyerjes së pagesave dhe titujve në sistemet e shlyerjes" dhe Direktivën 2002/47/KE (e ndryshuar) të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 6 qershor 2002 "Mbi marrëveshjet e kolateralit financiar".

Kolaterali financiar është një formë e re garancie, që mund të vendoset mbi *cash-in* dhe/ose instrumente të tjera financiare, për të siguruar shlyerjen e huave ose detyrime të tjera. Në ligj, *cash-i* përkufizohet, si: "...paratë e kredituara në një llogari në çfarëdo lloji valute apo pretendime të ngjashme të ripagueshme të parave, të tilla si depozitat monetare...", ndërsa instrumentet financiare, si: "...aksionet vendase ose të huaja dhe tituj të tjerë të ngjashëm me aksionet, obligacionet dhe format e tjera të instrumenteve të borxhit, nëse këto janë të negociueshme në tregun e kapitalit, tituj të tjerë të cilët normalisht tregtohen dhe që japin të drejtën për të tregtuar aksione, obligacione ose tituj të tjerë nëpërmjet anëtarësimit, blerjes apo këmbimit, ose që japin mundësinë e shlyerjes në para (me përjashtim të instrumenteve të pagesës), duke përfshirë kuotat në shoqëritë e investimeve kolekti-

Paqartësitë në ligj dhe mungesa e praktikës së konsoliduar e jurisprudencës, nuk krijojnë sigurinë e nevojshme që një garanci duhet të ofrojë te pala e siguruar, në rastin e marrjes dhe ekzekutimit të pengut mbi pasuritë e paprekshme sipas dispozitave të Kodit Civil.

ve, instrumente të tregut të parasë, metalet të çmuara të kredituara në një llogari, si dhe pretendime që kanë lidhje me/ose të drejta që rrjedhin nga elementet e sipërcituara...".

Kolaterali financiar mbi instrumentet financiare krijohet nëpërmjet një marrëveshje me shkrim dhe perfeksionohet ose nëpërmjet transferimit të zotërimit të kolateralit të marrësi i kolateralit, ose të një personi i autorizuar, ose kur instrumentet financiare mbahen, transferohen ose janë objekt i ndonjë mase, në mënyrë të tillë që marrësi i kolateralit apo personi i autorizuar, i posedon ose i kontrollon. E njëjta procedurë zbatohet dhe për kolateralin financiar mbi *cash-in*, posedimi i të cilit i transferohet marrësit të kolateralit apo transferohet në një llogari të veçantë, ose mbahet, transferohet ose është objekt i ndonjë mase, në mënyrë të tillë që marrësi i kolateralit apo personi i autorizuar, të zotërojë ose të ketë kontrollin mbi të. Marrësi i kolateralit njofton debitorin për transferi-

min e kryer, duke i bërë të ditur pretendimin mbi *cash-in* ose detyrimin e debitorit për të njohur shprehimisht ekzistencën e marrëveshjes së kolateralit financiar.

Marrëveshja e kolateralit financiar mund të lidhet vetëm ndërmjet personave juridikë, pra jo ndërmjet individëve dhe është e zbatueshme vetëm kur njëra nga palët e marrëveshjes është Republika e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë, një bankë qendrore e huaj, një banke, një institucion financiar, një institucion i huaj i ngjashëm me një bankë ose një institucion financiar, një agjent shlyerës, një operator, ose një autoritet publik vendas apo ndërkombëtar. Mënyra e ekzekutimit të kolateralit financiar rezulton të jetë e thjeshtë dhe nuk kërkon përfshirjen e gjykatës dhe/ose ndonjë autoriteti tjetër publik.

2. Garancitë mbi pasuritë e paprekshme

Nga data 1 janar 2000, kur hyri në fuqi ligji "Për barrët siguroese" (nr. 8537, datë 18.10.1999), garancitë në formën e barrëve siguroese mbi pasuritë e paprekshme (përfshirë, por pa u kufizuar në kuotat e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe/ose aksionet nominative të shoqërive aksionare, llogaritë e arkëtueshme, të drejtat nga kontratat etj.) janë krijuar me marrëveshje me shkrim të palëve dhe janë perfeksionuar nëpërmjet regjistrimit në Regjistrin e Barrëve Siguroese, duke e lejuar barrëdhënësin të ruante posedimin e tyre. Pas 13 vjetësh, duke filluar nga 29 maji 2013, marrja e garancive në këtë formë mbi pasuritë e paprekshme nuk është më e mundur, për shkak të ndryshimeve në ligjin "Për barrët

Për sa i takon pengut mbi të llogaritë e arkëtueshme dhe të drejtat nga kontratat, pyetja që ngrihet është, si do të transferohet zotërimi i tyre nga pengdhënësi te pengmarrësi, dhe në cilën mënyrë palët e treta do të vihen në dijeni për ekzistencën e pengut?

siguruese” të miratuara nga Kuvendi me ligjin 132/2013. Sipas ndryshimeve, barrët siguruese nuk mund të krijohen mbi pasuritë e luajtshme të paprekshme, instrumentet, letrat me vlerë dhe llogaritë. Kjo do të thotë që mbi pasuri si kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, shoqërive kolektive e komandite, aksionet nominative të shoqërive aksionare, llogaritë e arkëtueshme, të drejtat nga kontratat etj., nuk mund të krijohen më barrë siguruese. Ky ndryshim nuk prek krijimin e barrëve siguruese mbi pasuritë e luajtshme të prekshme.

Aktualisht, garancitë mbi pasuritë e paprekshme, të përmendura me lart, mund të merren në formën e pengut në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Kodi në nenin 546 përkufizon pengun si një mjet për të siguruar detyrimin, i cili mund të vendoset mbi pasuritë e luajtshme, mbi një të drejtë ndaj prurësit, ose mbi uzufruktin e kësaj pasurie ose të drejte. Pengu perfeksionohet duke vendosur pasurinë ose titullin në posedim të pengmarrësit ose të një pale të tretë të caktuar në marrëveshjen e palëve. Sipas paragrafit të dytë të nenit 143 të Kodit Civil, ku përcaktohet se: “...dispozitat që kanë të bëjnë me sendet e luajtshme zbatohen për gjithë të drejtat e tjera...”, në teori është e mundur gjithashtu vendosja e pengut mbi pasuritë e paprekshme. Gjithashtu, në zbatim të nenit 547 të Kodit, është e mundur të vendoset pengu mbi kuotat e shoqërive (me përgjegjësi të kufizuar, shoqërive komandite, kolektive dhe atyre aksionare) dhe të kryhet perfeksionimi i tij nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e anëtarëve/aksionarëve të shoqërisë.

Në praktikë, perfeksionimi efektiv dhe/ose ekzekutimi i pengut të vendosur sipas dispozitave të Kodit Civil mbi pasuritë e paprekshme, përfshirë dhe ato të përmendura më lart, është shumë i diskutueshëm. Kur diskutohet vendosja e pengut



mbi kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, komandite a kolektive, pyetja që lind është “çfarë është regjistri i anëtarëve?” Mund të prezumohet se çfarë mund të jetë ky regjister, por nuk gjejmë asnjë përkufizim të tij në Kodin Civil dhe/ose në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare (nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar). Ekziston një praktikë e depozitimit dhe njoftimit të marrëveshjeve të pengut pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), por a përben kjo procedurë perfeksionimin e pengut sipas kërkesave të Kodit Civil, dhe a do të konsiderohet regjistri tregtar i mbajtur nga QKR, si “regjistri i anëtarëve”? E njëjta pyetje vlen dhe për pengun mbi aksionet e një shoqërie aksionare. Në Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare gjejmë përkufizimin “regjistri i aksioneve” dhe jo “regjistri i anëtarëve”. Në këtë rast, a do të konsiderohet regjistri i aksioneve i përkufizuar nga ligji tregtar, si regjistri i aksionareve që referohet në Kodin Civil?

Për sa i takon pengut mbi të llogaritë e arkëtueshme dhe të drejtat nga kontratat, pyetja që ngrihet është, si do të transferohet posedimi i tyre nga pengdhënësi tek pengmarrësi, dhe në cilën mënyrë palët e treta do të vihen në dijeni për ekzistencën e pengut? Përgjigja e kësaj pyetjeje gjendet në cedimin e të drejtave sipas neneve 499 deri në 507 të Kodit Civil, por kjo mënyrë nuk është kthyer ende në një

praktikë të zakonshme. Ekzekutimi i pengut të marrë sipas dispozitave të Kodit Civil mbetet i paqartë. Sipas Kodit (neni 556), pengu ekzekutohet nëpërmjet shitjes me autorizimin e gjykatës të pasurisë së marrë peng. Vetëm në rastin e ekzekutimit të pengut mbi llogaritë e arkëtueshme dhe/ose të drejtat nga kontratat, sipas nenit 557, nuk është e nevojshme përfshirja e gjykatës. Në parim autorizimi i gjykatës është një vendim gjyqësor dhe si i tillë mund të ankimohet nga pengdhënësi në një gjykatë të një shkalle më të lartë (Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë). Sipas praktikës, apelimi i vendimeve gjyqësore krijon vonesa si dhe vështirëson procesin e ekzekutimit duke dëmtuar interesat e kreditorëve.

Si përfundim, mund të thuhet se paqartësitë në ligj dhe mungesa e praktikës së konsoliduar e jurisprudence, nuk krijojnë sigurinë e nevojshme që një garanci duhet të ofrojë te pala e siguruar, në rastin e marrjes dhe ekzekutimit të pengut mbi pasuritë e paprekshme sipas dispozitave të Kodit Civil. Këto mangësi bëjnë të nevojshme ndryshimet në legjislacion, ose duke shtuar në Kodin Civil një kre, ku të rregullohet mënyra e perfeksionimit dhe ekzekutimit të pengut mbi pasuritë e paprekshme, ose nëpërmjet rikthimit në ligjin për Barrët Siguruese të dispozitave të shfuqizuara me ndryshimet e fundit.

Eshtë koha për kartën tuaj të kreditit!



- **FALAS** për vitin e parë
- **Karta në dorën tuaj brenda 3 ditëve**
- **0%** për blerje në pikat e shitjes dhe Internet

Apliko ON LINE



Fibank
First Investment Bank

TELEFONONI PA PAGESË NË
0800 01 11

www.fibank.al

PLANI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM I BAZUAR NË RREZIK NË SEKTORIN BANKAR - DISA MENDIME



nga Dokt. Holtjana BELLO
Partnere/Konsulente
për rrezikun & Auditin

Një prej pyetjeve që unë shtroj gjithmonë në karrierën time profesionale dhe akademike është si të kuantifikoj universin e auditimit të brendshëm. Kësaj pyetje i përgjigjem: "...sidoqoftë është më lehtë të jesh një auditues sesa një shkencëtar." Profesor Brian Cox shkruan në periodikun Wall Street Journal, në prill 2013: "Teoria e kuantëve na tregon që universi ku ne jetojmë, lind nga ndërveprime konfuze dhe kaotike të pafundësisë me qeliza atomike të pakontrollueshme." Sigurisht, të përkufizosh universin e auditimit është më lehtë se teoria e kuantëve, megjithëse parimet mund të jenë të njëjta.

Përkufizimi i auditimit të brendshëm, i përcaktuar në Kuadrin e Praktikave Profesionale të Auditimit të Brendshëm, shpjegon qartë që: "auditimi i brendshëm duhet të shqetësohet për gjithçka që shqetëson organizatën dhe që ndërvepron me të." Sigurisht, të kuantifikosh qëllimin e operacioneve dhe rishikimin e tyre kërkon një punë të jashtëzakonshme. Kështu, në këtë univers pa fund të çështjeve të organizatës që shtrohen për t'u zgjidhur para auditimit, pyetja nuk është "cila është madhësia e universit të auditimit?", por "cila është shtrirja

Auditimi i brendshëm nuk duhet të fokusohet në të gjithë universin e auditimit, por në aspektet më të rëndësishme që ndihmojnë bankën të arrijë objektivat, duke ofruar siguri që sistemet e kontrolleve, qeverisja dhe menaxhimi i rreziqeve janë në nivelin e duhur.

e angazhimeve të auditimit, brenda ciklit të planit të punës së auditimit, kjo e shprehur në terma financiarë dhe operacionalë?"¹. Disa mendime, se çfarë duhet të marrë në konsideratë shefi i auditimit të brendshëm në një bankë, gjatë përgatitjes së planit të punës së auditimit mund të jenë si vijojnë:

Fillimisht, shefi i auditimit duhet të kuptojë cilat struktura të bankës i ofrojnë siguri bordit. Kjo gjë kërkon analizën e tre linjave të mbrojtjes, ku përfshihet analiza e rreziqeve bruto dhe neto. Rreziku neto mund të kategorizohet sipas tabelës në vijim:

- **E kuqe** – nivel që tejkalon kufirin e "oreksit për rrezik", të vendosur nga bordi;
- **E verdhë** – nivel që kërkon monitorim të vazhdueshëm nga ana e menaxhimit;
- **E gjelbër** – niveli që nuk ka probabilitet të shkaktojë ndërprerje të veprimeve operacionale.

Cila është qasja e auditimit sipas zonave?

- **Zona e kuqe** - Niveli i lartë i ekspozimit bruto të rrezikut, i shoqëruar nga kontrolle të pamjaftueshme, kërkon që aktivitetet e auditimit të fokusohen në vlerësimin e kontrolleve të brendshme, p.sh.: duke dhënë rekomandime për të përmirësuar më tej kontrollet, apo duke vlerësuar planet e përmirësimit të kontrolleve

të ngritura nga vetë menaxhimi. Roli që merr auditimi këtu ka natyrë këshilluese;

- **Zona e verdhë** - Në rastet kur vlerësohet nga menaxhimi që niveli i ekspozimit të riskut është i lartë, por që kontrollet e ngritura janë në nivelin e duhur për të reduktuar risqet brenda nivelit të oreksit për risk, aktivitetet e auditimit duhet të fokusohen në **dhënien e sigurisë** që kontrollet funksionojnë në mënyrën e duhur dhe që risqet menaxhohen në mënyrë efektive. Ky është rasti që nëse kontrollet dështojnë, kompania do të ekspozohet ndaj një niveli risku të papranueshëm dhe gati katastrofik;
- **Zona e gjelbër** - karakterizon aktivitetet operacionale të organizatës. Niveli i ulët i ekspozimit të rrezikut që gjithashtu shoqërohet nga kontrolle të ulëta, i pranuar si i tillë nga vetë menaxhimi, nxit auditimin të monitorojë nivelin e zhvillimit të rrezikut dhe të sigurojë bordin që kontrollet janë ngritur dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Nga ana tjetër, niveli i ulët i ekspozimit të rrezikut që shoqërohet me kontrolle të forta në disa raste mund të gjenerojë rekomandime të auditimit, për të rritur eficiencën e proceseve. Pra, aspekti kryesor i planit të punës së auditimit është analiza e

1. Pritchard, R. (2013). "What planet are you on?", July/ August 2013, p.22

rreziqeve, që do të thotë jo vetëm identifikimi i rreziqeve që ndesh biznesi, por edhe marrja në konsideratë e kontrolleve që janë ngritur për t'i menaxhuar ato. Analiza shtron më tej pyetjet se si vlerësohen fushat e ekspozuara më shumë ndaj rreziqeve, si dhe cilat janë kontrollet që ngrihen për të menaxhuar ato? Si përcaktohen fushat e auditueshme që do t'i dërgohen në vëmendje komitetit të auditimit? Shefi i auditimit të brendshëm duhet të marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm për të përcaktuar prioritetet në lidhje me angazhimet e auditimit që do të përfshihen në planin 1-vjeçar të punës:

a) Objektivat dhe qëllimet e bankës

Plani i auditimit të brendshëm duhet të jetë në të njëjtën linjë me drejtimin strategjik të bankës dhe të pasqyrojë faktin që auditimi i brendshëm njuh dhe kupton qëllimet, objektivat dhe prioritetet e bankës.

b) Konsulta dhe opinione nga bordi, menaxhimi ekzekutivë dhe menaxherë të tjerë të bankës

c) Mjedisi i jashtëm

Politikat monetare të Bankës së Shqipërisë, kushtet sociale dhe makroekonomike të vendit, si dhe pritshmëritë e grupeve të jashtme të interesit janë të gjithë faktorë, që duhet të merren në konsideratë nga shefi i auditimit të brendshëm, gjatë përgatitjes së planit të auditimit. Burimet e jashtme, përfshirë këtu raportet e strukturave të tjera që ofrojnë siguri, të tillë si: rregullatorët dhe audituesët e jashtëm ku përmenden burime të mundshme rreziqesh, ndihmojnë auditimin e brendshëm gjatë përgatitjes së planit.

d) Rreziqet e bankës

Rreziqet aktuale dhe ato të ardhme kanë ndikim të rëndësishëm në planin e auditimit të brendshëm. Në bankat që kanë një sistem të maturuar të menaxhimit të rrezikut, pra kur vetë menaxhimi ka ngritur sisteme të forta për të identifikuar, matur, vlerësuar dhe raportuar rrezikun, atëherë plani dhe regjistri i menaxhimit të rreziqeve të bankës kthehet në një burim kyç informacioni në zhvillimin e planit të auditimit. Nëse bankat nuk kanë zhvilluar ende sistemet dhe proceset e menaxhimit të rreziqeve, atëherë auditimi i brendshëm duhet të zhvillojë vete profilin e rreziqeve të bankës, për qëllime të planit të auditimit. Profili i rreziqeve do të ndërtohet nga auditimi, duke diskutuar hartën e rreziqeve dhe mënyrën e menaxhimit të tyre, përfshirë këtu

Renditja formale e rreziqeve neto						
NDIKIMI NE BIZNES	Kritike 4	12	14	15	16	Ekspozimi paparanueshem ndaj rrezikut qe kerkon veprime te menjehershme te menaxhimit
	Të mëdha 3	8	10	11	13	
	Të mesme 2	4	5	6	9	Duhet te merren masa per menaxhimin e rreziqeve, si dhe të monitorohen me tej
	Të ulëta 1	1	2	3	7	
		Pothuajse asnjëherë 1	Pak 2	Shpesh 3	Pothuajse gjithmonë	Nivel i pranueshem rreziku që është objekt i vazhdueshem monitorimi
PROBABILITETI I NDODHJES						

edhe kontrollet e ngritura me komitetin e auditimit dhe menaxhimin.

e) Harta e dhënies së sigurisë

Është e rëndësishme që siguria e ofruar nga auditimi të plotësojë dhe jo të dublojë punën e kryer nga funksionet e tjera të brendshme, ose të jashtme që kryejnë gjithashtu aktivitetet rishikuese. Kjo gjë realizohet duke analizuar rreziqet domethënëse, me të cilat ndeshet banka dhe shkallën e dhënies së sigurisë, prej secilës strukturë që ofron siguri. Ky ushtrim mund të jetë një mënyrë e mirë për të kuptuar gjithë hartën e dhënies së sigurisë të bankës nga një perspektivë më e gjerë dhe më e plotë dhe për rrjedhojë të ndihmojë auditimin e brendshëm të shmang boshllëqet ose dublimin e fushave të rishikuara.

Gjithashtu, shefi i auditimit mund të përdorë disa kriteret, për të vlerësuar rrezikun dhe kontrollet e ngritura në bankë, për çdo fushë të auditueshme (shih BOX-in).

Çdo kriter mund të pikëzohet dhe ky sistem pikëzimi ndihmon në renditjen e fushave të auditueshme dhe në caktimin e prioriteteve të auditimit, për vitin në vazhdim. Megjithatë, ky proces kërkon gjykimin e shëndoshë të shefit të auditimit, për të përcaktuar nivelin e pikëve që do të marrë çdo fushë për çdo kriter të vendosur. Si përfundim, mund të shtohet që vendosja e prioriteteve, lidhur me fushat e auditueshme është në fakt elementi dallues, që e bën një plan pune të bazohet në rrezik. Për këtë arsye, auditimi i brendshëm nuk duhet të fokusohet në të gjithë universin e auditimit, por në aspektet më të rëndësishme që ndihmojnë bankën të arrijë objektivat, duke ofruar siguri që sistemet e kontrolleve, qeverisja dhe menaxhimi i rreziqeve janë në nivelin e duhur.

KRITERET PËR VLERËSIMIN E RREZIKUT DHE KONTROLLEVE NË BANKË

- Sistemi i kontrolleve të brendshme
 - Kontroll dhe monitorim nga menaxhimi
 - Aktivitete kontrolli dhe ndarje detyrash
 - Informacion dhe komunikim
 - Aktivitete monitoruese dhe korrigjim defektesh
- Sistemi, Organizimi dhe ndryshimet në Teknologjinë e Informacionit
 - Gabime të njohura
 - Përdorim i teknologjive/ sistemeve të reja
 - Zhvillimi i produkteve të reja
 - Ndryshimi i stafit
 - Numri i stafit
- Kompetenca dhe integriteti i personelit
 - Eksperienca dhe arsimimi
 - Integriteti
- Gabime dhe ankesa
 - Parregullsi të mundshme
 - Ankesa
 - Mystery Shopping
- Rëndësia e ardhme strategjike
 - Mundësi për të kursyer kostot
 - Mundësi për të rritur të ardhurat
- Koha që prej auditimit të fundit të kryer
- Rezultatet e auditimit të fundit
- Kërkesa nga rregullatorët për auditime speciale (ASD, DPPPP)
- Kërkesa specifike nga grupet e brendshme të interesit
 - Bordi i Drejtorëve
 - Komiteti i Auditimit
 - Menaxhimi Ekzekutiv
- Ecuria e degëve
 - Vëllimi i llogarive rrjedhëse
 - Vëllimi i depozitave me afat
 - Vëllimi i huave me kufi dhe kartave të kreditit të disbursura

POLITIKAT MONETARE: STABILITETI I ÇMIMEVE PËRBALLË STABILITETIT FINANCIAR



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI
President & Drejtor
i Shkollës Doktorale
Universiteti European i Tiranës, UET

Kriza ekonomiko-financiare globale e viteve 2008-2013 i përballi politikat monetare me sfida të reja në lidhjet dhe ndërlikimet që ato kanë me stabilitetin financiar në përgjithësi dhe politikat e menaxhimit të borxheve e deficiteve buxhetore në veçanti. Pyetja më thelbësore që shtrohet ndaj politikave monetare, qëndron në faktin nëse përtej mandatit të tyre "klasik" në sferën e stabilitetit të çmimeve dhe kontrollit të inflacionit, a duhet që politikat monetare të luajnë një rol më të rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit financiar, zvogëlimin e efekteve negative të borxheve sovraane dhe përmirësimit të shëndetit ekonomik në përgjithësi? Për momentin ky është një debat teorik e akademik shumë i pranishëm në mjediset shkencore, bankat qendrore dhe katedrat universitare, duke mos pasur ende një përgjigje konsensuale në gjirin e ekspertëve e të studiuesve të politikave monetare. Në qendër të vëmendjes është fakti se përpara krizës financiare kishte një konsensus thuajse absolut për detyrat dhe fushën e veprimit të politikave monetare, ndërkohë që për këtë periudhë paskrizë financiare, lidhjet ndërmjet politikave monetare dhe stabilitetit financiar janë ende duke u studiuar e analizuar.

Gjatë 3-4 dekadave të fundit, de-

batet rreth politikave monetare janë përqendruar në lidhjet ndërmjet inflacionit dhe veprimtarisë ekonomike, ndërkohë që problematika e stabilitetit/destabilitetit financiar është parë si një objektivi mjaft anësor i saj. Ekspertët e shpjegojnë këtë me faktin se, gjatë gjysmës së dytë të shekulli XX, ekonomitë e vendeve të zhvilluara nuk u përballën asnjëherë me një krizë financiare, të ngjashme me krizën globale aktuale. Ekonomitë e këtyre vendeve kaluan nga periudha e inflacionit të lartë dhe stagflacionit të viteve '70, në një periudhë joinflacioniste në vitet '80, duke

Bankat qendrore duhet të marrin më shumë në konsideratë, në analizat për vendimmarrjen e tyre në politikat monetare, elementët që shkaktojnë çekuilibra financiarë, pasi kriza tregoi se rreziqet e stabilitetit financiar janë gjithashtu edhe rreziqe të stabilitetit të çmimeve, që nënkupton një zgjerim të horizontit të politikave monetare dhe një ndryshim në komunikimin e tyre në raport me publikun dhe aktorët ekonomikë.

Kriza financiare globale aktuale nxori në plan të parë rëndësinë e stabilitetit financiar dhe tregoi qartësisht se vetëm objektivi i stabilitetit të çmimeve është i pamjaftueshëm për të garantuar stabilitetin makroekonomik dhe veçanërisht çështjet e borxheve sovraane dhe deficiteve buxhetore.

arritur në përfundimin se: "inflacioni nuk kishte prodhuar rritje ekonomike të qëndrueshme dhe zvogëlim të papunësisë, përkundrazi, kishte çuar në një destabilitet monetar, me pasoja negative për rritjen dhe punësimin". Ndërkohë, ky dezinflacion kishte prodhuar dhe një ulje të luhatshmërisë makroekonomike.

Përtej debateve mbi efektet e favorshme makroekonomike të kësaj periudhe, mbi ndikimin e ristrukturimit të mjaft ekonomive, apo përmirësimit të teknikave të drejtimit, duket se ka një konsensus të gjerë, lidhur me efektin pozitiv të politikave monetare të ndjekura në këtë periudhë. Së pari, se evolucioni afatgjatë i inflacionit ishte përcaktuar nga politikat monetare të zbatuara, që kishin si objektivi kryesor "stabilitetin e çmimeve", pra stabilizimin e inflacionit ose shënjestrimin e tij; së dyti, se objektivi i stabilitetit të çmimeve nuk ka kosto të ndjeshme për veprimtarinë ekonomike, ndërkohë që politikat monetare që kishin synuar rritjen ekonomike, kundrejt çmimit të një inflacioni të lartë, kishin dështuar. Ideja se garantimi i stabilitetit të çmimeve ishte kontributi më i mirë që politika monetare mund të jepte për rritjen ekonomike dhe për punësimin kishte triumfuar, ndërkohë që bankat qendrore ishin orientuar më shumë drejt shënjestrimit fleksibel të inflacionit, në vend që të zbatonin një shënjestrim rigoroz të inflacionit; së treti, te roli që kishte luajtur parapritja e inflacionit në vetë procesin inflacionist, pra te efekti pozitiv i premti-

Pyetja e shtruar për zgjidhje është: a duhet që në të ardhmen të mendohet për një mandat më të gjerë për politikën monetare, në mënyrë që ato të kontribuojnë më drejtpërdrejt në çështjet e stabilitetit financiar?

meve dhe besimit të bankat qendrore se ato do t'i qëndronin rigorozisht objektivitetit të stabilitetit të çmimeve; së katërtri, konsensusi se bankat qendrore kishin nevojë për një kuadër ligjor e institucional të qëndrueshëm, që forconte autoritetin dhe besueshmërinë e politikave monetare dhe përqendrimin e tyre vetëm në objektivitetin e stabilitetit të çmimeve.

Ekzistenca e mandateve të qarta për "stabilitetin e çmimeve" bëri që shumë banka qendrore ta përkthenin këtë mandat në objektiva sasiorë të inflacionit, gjë që krijonte një ankorim nominal të pritshmërive për nivelin e inflacionit. Bankat qendrore e rritën shkallën e transparencës dhe komunikimit, duke bërë që parashikimet e agjentëve ekonomikë të ishin shumë afër objektivitetit të bankës qendrore. Pavarësia e bankave qendrore e rriti akoma më tepër besueshmërinë e tyre. Edhe strategjia e politikës monetare të Eurozonës përcaktonte stabilitetin e çmimeve, si objektivin kryesor të politikës monetare të BQE-së, duke e nënvizuar qartë një gjë të tillë në traktatet e funksionimit të BE-së.


Para shpërthimit të krizës, pra, përpara vitit 2008, ekzistonte gjithashtu një konsensus i gjerë edhe për lidhjet midis politikave monetare dhe stabilitetit financiar, pasi me garantimin e stabilitetit të çmimeve politika monetare ndihmonte drejtpërdrejt edhe në stabilitetin financiar, aq më tepër që vetë stabiliteti financiar lehtësonte transmetimin e vetë politikës monetare, transmetim që nuk ishte tronditur asnjëherë si në rastin e krizës financiare globale të viteve 2008-2013. Dy dekadat përpara krizës financiare u shfaqën si një "koïncidencë hyjnore", në të cilën politika monetare e fiksuar të stabilitetit të çmimeve dhe niveli i inflacionit mjaftonte tërësisht për të garantuar stabilitetin financiar e makroekonomik. Shumë autorë shkojnë akoma më larg kur nënvizojnë se: "politikën monetare lehtësuese e akomoduese ishin ato që mbollën farën e krizës financiare

globale dhe stimuluan aventurat drejt rreziqeve të mëdha të ndërmjetësve apo derivateve financiarë".

Megjithatë, për mjaft ekspertë financiarë, objektivi i stabilitetit të çmimeve ishte një kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm, për të garantuar stabilitetin financiar, pasi stabiliteti financiar përfitonte më shumë nga politikat prudenciale të rregullimit dhe kontrollit sesa nga ato monetare. Debatimi më i madh zhvillohej për faktin nëse politika monetare duhej të konsideronte apo të neglizhonte çështjen e çmimit të aktiveve, e nëse po, në çfarë formash e me çfarë mënyrash? Një kategori ekspertësh mbrojnë pozicionin se "çmimet e aktiveve, apo variablat e tjerë financiarë, duhet të merreshin në konsideratë nga politikat monetare vetëm në rastet kur ato krijojnë pasoja në ecurinë e inflacionit në periudha më të shkurtra se 2 vjet që mbulonin vendimet bazë të politikave monetare". Pra, ato nuk mund të ishin objektiva specifike, por thjesht tregues që merreshin në konsideratë nga bankat qendrore, kur bënin parashikimin e inflacionit dhe rritjes, pasi flluskat financiare ishin e vështirë të identifikoheshin në kohë reale dhe se këto flluska nuk krijojnë detyrimisht destabilitet financiar, apo luhatje makroekonomike të rëndësishme. Ndërkohë, një kategori tjetër ekspertësh mbrojnë pozicionin se "bankat qendrore duhej të merrnin në konsideratë çmimet e aktiveve dhe çekuilibrat financiarë edhe përtej pasojave që këto mund të kishin mbi inflacionin, pra për peri-

dha më të gjata se 2 vjet". Ata e vinin theksin te pasojat negative makroekonomike që mund të shkakttoheshin nga shpërthimi i flluskave financiare, duke u përpjekur të frenohen ngritjet e çmimeve të aktiveve, nëpërmjet politikave të quajtura "kundra rrymës". Megjithatë, gjatë gjithë periudhës 1970-2007, ishte grupi i parë ai që dominoi.

Por, ky konsensus gati 50-vjeçar mbi rolin dhe objektivat e politikave monetare u prish nga kriza financiare globale e shpërthyer në vitin 2008. Megjithëse është akoma shpejt të arrihet në konkluzione konsensuale mbi mësimet e krizës, në debatet e analizat mbi të ardhmen e politikave monetare po sintetizohen disa "leksione" që duhen marrë në konsideratë për periudhën e re post-krizë që duket se po fillon me vitin 2014. Si të tilla mund të përmenden: (1) stabiliteti i çmimeve nuk mjafton për të garantuar stabilitetin financiar, dhe aq më pak për të garantuar stabilitetin makroekonomik. Inflacioni nuk është aspak lakmushi i duhur që të paralajmëron për flluskat e ardhshme financiare e monetare që po krijojnë e mund të shpërthejnë nga çasti në çast, aq më tepër që këto flluska të çojnë menjëherë në destabilitet financiar e makroekonomik, duke vështirësuar së tepërmi transmetimin e vetë masave të politikave monetare. Garantimi i stabilitetit makroekonomik nuk arrihet vetëm duke synuar stabilitetin e çmimeve, por dhe duke kërkuar politikat prudenciale; (2) an-



korimi i pritshmërive të inflacionit ka mbetur solid edhe në periudha krize, gjë që nënkupton, se edhe në kushtet e tkurrjes së aktivitetit ekonomik si pasojë e krizës, politikat monetare lehtësuese kanë efekte pozitive; (3) identifikimi i destabilitetit financiar në kohë reale kërkon evidentimin dhe studimin e shumë indikatorëve specifikë përtej çmimit të aktiveve, si objektiv të politikave monetare, të tillë si çmimet në sektorin e pasurive të patundshme, nivelin e borxhit të aktorëve ekonomikë, kostot e financimit të bizneseve, ecurinë e kredisë, destabilitetin e financave publike dhe borxheve sovraane etj.; (4) jo vetëm politikat monetare, por dhe politikat prudenciale dhe ato ekonomike duhet të përfshihen seriozisht në administrimin e destabilitetit financiar. Politikat monetare nuk mund ta luftojnë të vetme krizën ekonomike dhe destabilitetin financiar. Në këto kushte kërkohet forcimi i rolit dhe prezencës së politikave mikro e makroprudenciale, me qëllim eliminimin e rreziqeve sistemike. Politikat makroprudenciale eficientë me synim për të rritur kapacitetet e rezistencës së sistemeve financiare ja lehtësojnë fushën e veprimit politikave monetare. Fakti që politika monetare kontribuon në stabilitetin financiar nuk shkon në drejtim të kundërt me stabilitetin e çmimeve. Një nga mësimet e krizës është pikërisht se *“të përqendrohesh veçanërisht në stabilitetin e çmimeve, në një horizont që nuk i kalon 2 vitet, përbën rrezik për stabilitetin financiar dhe për pasojë, për vetë stabilitetin afatgjatë të çmimeve”*. Fakti që politika monetare mund të ndikojë në stabilitetin financiar bën që ajo të realizojë më mirë dhe objektivin klasik të saj, stabilitetin afatgjatë të çmimeve; (5) domosdoshmëria e përcaktimit të mandateve të qarta për politikat monetare dhe ato makroprudenciale, në mënyrë që të rritet efica e këtyre dy politikave edhe nëpërmjet kombinimit të tyre.

Si përfundim, mund të thuhet se kriza financiare globale aktuale nxori në plan të parë rëndësinë e stabilitetit financiar dhe tregoi qartësisht se vetëm objektivi i stabilitetit të çmimeve është i pamjaftueshëm për të garantuar stabilitetin makroekonomik dhe veçanërisht çështjet e borxheve sovraane dhe deficiteve buxhetore. Pyetja e shtruar për zgjidhje është: a duhet që në të ardhmen të men-



dohet për një mandat më të gjerë për politikat monetare, në mënyrë që ato të kontribuojnë më drejtpërdrejt në çështjet e stabilitetit financiar? Në komunitetin e ekspertëve të politikave monetare dhe bankave qendrore po fillon të zërë vend mendimi se, për të garantuar stabilitetin financiar duhen forcuar politikat prudenciale dhe veçanërisht ato makroprudenciale që kufizojnë rreziqet sistemike, që burojnë kryesisht nga ndërveprimi e ndërlidhjet midis institucioneve të sistemit financiar dhe pjesës tjetër të sistemit ekonomik. Shkaqet e destabilitetit financiar janë të ndryshme në vende të ndryshme të botës. Politikat makroprudenciale eficiente lehtësojnë fushën e veprimit të politikave monetare, i shmangin atyre përfshirjen në objektiva shtesë, përtej atij të stabilitetit të çmimeve, pasi kjo krizë tregoi qartë domosdoshmërinë dhe efektshmërinë e parapritjes së inflacionit dhe besueshmërisë së bankave qendrore në politikat monetare

të stabilitetit të çmimeve. Bankat qendrore duhet të marrin më shumë në konsideratë, në analizat për vendimmarrjen e tyre në politikat monetare, elementët që shkaktojnë çekuilibra financiarë, pasi kriza tregoi se rreziqet e stabilitetit financiar janë gjithashtu edhe rreziqe të stabilitetit të çmimeve, që nënkupton një zgjerim të horizontit të politikave monetare dhe një ndryshim në komunikimin e tyre në raport me publikun dhe aktorët ekonomikë. Por edhe në këtë pikë, ekspertët ndahen në dy grupe, lidhur me misionin e bankave qendrore dhe domosdoshmërinë e artikullimit ndërmjet politikave monetare dhe makroprudenciale. Njëri grup mendon se duhet të ekzistojë një ndarje e qartë ndërmjet politikave monetare dhe atyre makroprudenciale, ndërkohë që tjetri mbron pozicionin e një koordinimi të tyre dhe shfaqjen si një politikë të vetme, në kuadrin e bankave qendrore.

SË BASHKU

Ndërtojmë marrëdhënie që zgjasin



ICB është banka Boutique ku çdo klient është mbi të gjitha një partner në një marrëdhënie të gjatë.

www.icb.al
☎ 068 408 8000

Zyra Qendrore:
International Commercial Bank
Rr. Murat Toptani, Qendra Eurocol, Tirana, Albania

Për informacione të mëtejshme ju lutemi
na vizitoni në degën më të afërt të
International Commercial Bank,
në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lushnjë



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK
rëndësi kanë vlerat

KOLOSËT UNIVERSITARE BOTËRORE NË FUSHËN E EKONOMISË SILLEN NË SHQIP NGA UET PRESS

nga **Z. Andi BIDOLLARI**

Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun
Universiteti European i Tiranës

Eni botues i Universitetit European të Tiranës, UET Press, tashmë ka krijuar biografinë e tij për të dalë në mjedisin publik shqiptar në një rol të dyfishtë, jo vetëm si një botues serioz dhe i plotë me një strategji të caktuar dhe transparente në lidhje me botimet shkencore në vend, por edhe si një botues i cili rrezaton më gjerë, ka ndikim në jetën publike dhe editorialet shqiptare nëpërmjet politikave editoriale të rëndësishme për të bërë të mundur pikërisht kalimin në një momentum të ri të botimeve shqiptare, në një botë që ndryshon më shumë, sidomos që ndryshon shumë shpejt, e aq më shumë në format e komunikimit. UET Press është një antenë e botimeve më të mira vendase apo të huaja, të cilat i duhen jo thjesht studentit e kërkuesit shqiptar, por edhe mjedisit shqiptar në tërësi.

Kolana Kurrikulum (botimet universitare) është kolana bazë ose themelore e UET në të cilën janë botuar deri më sot më shumë se 100 vepra dhe planifikohen dhe 100 të tjera. Këto janë tekste bazë universitare nga pesë nga shtëpitë më të njohura, markat e mëdha botuese ndërkombëtare si: Elsevier, Pearson, Sage, Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill Press, etj. Botues që sot në tregun akademik dhe shkencor botëror zotërojnë thuajse kapitalin cilësor më të rëndësishëm në botimet shkencore. Studentëve tani ju ofrohen manuale, tekste bazë, libra ushtrimesh apo literaturë parësore të këtij standarti duke krijuar mundësi që të rritet me shpejtësi niveli i mësimdhënies për aq sa mësimdhënia varet nga teksti apo literatura. Kjo kolanë e disponueshme për studentët dhe pedagogët shqiptarë gjithandëj, ka krijuar një standard të ri në lidhje me botimet shkencore kundër plagjiaturës, kundër prapambetjes dhe kundër merkantilizimit të skajshëm të boti-

meve të pedagogëve, të cilët janë shpesh herë plagjiaturë ose në rastin më të mirë shumë larg cilësisë bashkëkohore, apo në një farë mënyre botohen thjesht e vetëm për t'ju shitur studentëve.

Universiteti European i Tiranës synon që çdo lëndë të ketë tekst bazë më të njohurin dhe më të përdorurin e asaj fushe në universitetet botërore dhe kjo është filozofia në qendër të kolanës së botimeve universitare në fushën e ekonomisë nga Universiteti European i Tiranës. Për të ndihmuar këtë synim, UET Press ka botuar disa nga titujt më të mirë ndërkombëtar në studimet ekonomike, ku libri i botuar së fundmi është "Parimet e Marketingut" i Philip Kotler dhe Gary Armstrong. "Parimet e Marketingut" është teksti bazë uni-

versitar më i rëndësishëm në botë për marketingun: një përjasje praktike dhe menaxheriale ndaj marketingut. Është i pasur në shembuj dhe aplikime që tregojnë vendimmarrjet kryesore me të cilat përballesh menaxherët në përpjekjet e tyre për të balancuar objektivat dhe burimet ndaj nevojave dhe mundësinë në tregun global.

Botimet në shqip vijnë të përkthyer nga profesionistë të fushës, pedagogë të lëndëve përkatëse. Disa nga tekstet që pritet të botohen në kolanën e teksteve ekonomike kanë të bëjnë me profilet e reja të kësaj shkence siç janë Menaxhimi i Investimeve, Menaxhimi Financiar, Paraja dhe Banka, apo Teoritë Ekonomike të BE-së.



BOTIME TË UET PRESS

Librat e botuar tashmë nga UET Press si pjesë e kolanës së botimeve universitare në fushën e ekonomisë janë:

Të botuara:

1. Bazat e financës - Herbert Mayo
2. Ekonomiksi: Makroekonomia & Mikroekonomia - N. Gregory Mankiw & Mark P. Taylor
3. Bazat e menaxhimit. Koncepte dhe aplikime themelore. Botimi i gjashtë. – Stephen P. Robbins, David DeCenzo, Mary Coulter
4. Hyrje në menaxhimin e burimeve njerëzore – Paul Banfield, Rebecca Kay
5. Financa publike. – Harvey S. Rosen
6. Hyrje në biznes – Julian Gaspar, Leonard Bierman, James Kolari, Richard Hise, L. Murphy Smith
7. Parimet e marketingut – Philip Kotler, Gary Armstrong
8. Statistika për biznes dhe ekonomik. Botimi i dhjetë. Pjesa e dytë. – David R. Anderson, Dennis J. Sweeney, Thomas A. Williams

Në proces botimi:

1. Ekonomiksi ndërkombëtar. Teoria dhe politika. – Paul R. Krugman & Maurice Obstfeld
2. Menaxhimi. Drejtimi & bashkëpunimi në botën konkurruese. – Thomas S. Bateman, Scott A. Snell

ALPHA BANK - ALBANIA

Dhurim për festat e fundvitit

Me rastin e festave të fundvitit, Alpha Bank Albania përdori fondin e buxhetuar për printimin e kartolinave, për të mbështetur familjet e Martirëve të Policisë së Shtetit. Drejtori i Përgjithshëm i bankës, Z. Periklis Drougkas, ndër të tjerat u shpreh se kjo nismë vjen pasi Krishtlindje do të thotë të falësh më shumë dashuri dhe të bësh më shumë për ata që kanë nevojë. Gjithashtu, këtë fund viti stafi i bankës vizitoi ambientet e “Shtëpisë së Foshnjës në Tiranë” dhe dhuroi lodra dhe veshje të ndryshme.

Mbështetje e konkursit “Vlora 2013”

Alpha Bank Albania mbështeti Konkursin Letrar “Vlora 2013” me botime në prozë, poezi, letërsi për fëmijë etj. Përfaqësues së Bankës morën pjesë gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimeve dhe drejtorja e Degës Vlorë dorëzoi çmimin “Petro Marko”.



BKT

“The Banker” vlerëson BKT si “Bankën më të mirë në Shqipëri” për vitin 2013

BKT u vlerësua sërish si “Banka më e mirë në Shqipëri” për vitin 2013. Revista prestigjioze financiare “The Banker” ka vlerësuar menaxhimin e suksesshëm financiar të BKT-së, rritjen e qëndrueshme të përfitueshmërisë dhe pjesës së tregut, si dhe risitë bankare. Çmimi iu dorëzua kryetarit të Bordit Drejtues, Z. Mehmet Usta, dhe drejtorit të Përgjithshëm dhe anëtarit të Bordit Drejtues, Z. Seyhan Pencablilig, në mbrëmjen gala të organizuar në Londër.

Mbështetje për nismën “Ta pastrojmë Shqipërinë në një ditë”

Në kuadër të politikës së saj të përgjegjshmërisë sociale, Banka Kombëtare Tregtare mbështeti nismën e shoqatës Green Line Albania për aktivitetin masiv të zhvilluar më 22 nëntor 2013 për pastrimin e plehrave në të gjithë Shqipërinë.



CREDINS BANK

Me rastin e festave të fund vitit, Credins Bank ofroi kontributin e saj për Qendrën Kombëtare të Kulturës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, nëpërmjet dhuratave për 3.000 fëmijët e çerdheve të Tiranës dhe për 300 fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës.

Gjithashtu, në vijim të përkujdesjes dhe vëmendjes së veçantë për promovimin e Artit u mbështet Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit për realizimin e shfaqjes Gala me rastin e 60-vjetorit, si dhe shfaqja e veçantë e regjisorit Kiço Londo.

CREDIT AGRICOLE

Më 27 tetor, u zhvillua për të pestin vit radhazi aktiviteti mbi ndërgjegjësimin ndaj kancerit të gjirit dhe Credit Agricole mbështeti këtë aktivitet të rëndësishëm, ku pati përfaqësues nga të gjitha shtresat sociale.

Stafi i bankës u përfshi në mënyrë aktive, duke ndihmuar të pranishmit me informacion dhe udhëzime për kryerjen e vetë-kontrolleve, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e zbulimit të hershëm të sëmundjes.

Në fund të aktivitetit u shpërndanë fletushka informuese dhe broshura promovuese, si dhe ëmbëlsira dhe dhurata simbolike nën logon e bankës Credit Agricole Shqipëri.



FIRST INVESTMENT BANK

Në traditën e Fibank, që bashkë me urimet e sezonit të festave të fund vitit, të kontribuonin për ata që kanë më shumë nevojë për mbështetje, këtë vit kartolinat e urimit u blenë në favor të Fondacionit “Down Syndrome Albania”. Fibank do të mbështesë në vazhdimësi këtë fondacion të krijuar së fundmi në Shqipëri për mbështetjen e përkujdesjen e fëmijëve me sindromën Down.



INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Live ART në Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë e Shkodër

Intesa Sanpaolo Bank Albania ekspozoi veprat e 26 finalistëve të Konkursit të Pikturës LiveART 2013 në Tiranë, pranë Galerisë Kombëtare të Arteve më 1-10 tetor, në Durrës në Galerinë e Artit Pamor "Nikolet Vasia" më 1-30 nëntor, në Vlorë në hollin e Teatrit "Petro Marko" më 14-30 nëntor, dhe në Korçë në qendrën kulturore "Guri Madhi" më 13-30 dhjetor 2013. Ky projekt përfolcon impenjimin e Bankës në promovimin e kulturës dhe artit, në zbatim të parimeve të Përgjegjësisë Sociale të Korporatës. LiveART do të kthehet në traditë të përvitshme.

Dy bursa për studentët Shqiptarë në Itali

Banka sponsorizoi këtë vit 2 Bursa Studimi për studentët Shqiptarë në Universitetet Italiane, në kuadër të Projektit të Ambasadës Italiane për të mbështetur të rinjtë shqiptarë me rezultate të larta në vazhdimësinë e studimeve të tyre. Dy studentët Grigor Angjeliu dhe Eljona Muçostepa përfituan nga 2000 euro secili. Çeçet u dorëzuan nga drejtori i Divizionit të Retail Z. Prestopino, në ceremoninë e organizuar nga Instituti Italian i Kulturës në kuadër të "Javës së gjuhës Italiane".

Dhurimi Vullnetar i Gjaktut - Një akt human që shpëton një jetë!

Tashmë i konsoliduar, Grupi i Dhuruesve Vullnetarë të Gjaktut të kësaj banke organizoi iniciativën e dytë të dhurimit për këtë vit, pranë degës në Rugën e Barrikadave dhe në zyrat qendrore, në datat 7-8 nëntor 2013. Në këtë dhurim morën pjesë rreth 35 kolegë. Numri i dhurimeve përgjatë 2013 është mbi trefishuar krahasuar me vitin 2012, falë angazhimit të kolegëve në këtë iniciativë humane dhe rritjes së ndërgjegjësimit në Bankë mbi Dhurimin Vullnetar.

Mbështetje nismës: "Le të pastrojmë Shqipërinë në 1 ditë"

"Le të pastrojmë Shqipërinë në 1 ditë", pjesë e iniciativës globale "Le ta bëjmë! Pastrimin e Botës!", u organizua si iniciativë e brendshme falë angazhimit vullnetar të kolegëve nën moton "Ne jemi Historitë tona! Ne jemi Intesa Sanpaolo Bank!". Zonat që u pastruan me pjesëmarrjen vullnetare të stafit ishin pranë Tiranës së Re, brenda në kompleksin sportiv "Dinamo", si dhe në ambientin përreth Degës së bankës në Kombinat.

Dita e Personave me Aftësi të Kufizuara, në Korçë

Banka mbështeti aktivitetin e Bashkisë së Korçës organizuar më 3 dhjetor 2013 në pallatin e sportit "Tamara Nikolla" me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Fëmijët e këtij komuniteti morën pjesë në aktivitete të ndryshme sportive e kulturore me temën "Edhe ne Mundemi".

Dhurime fëmijëve të fshatit SOS

Stafi i Intesa Sanpaolo Bank Albania vizitoi fëmijët e fshatit SOS të premten më 27 dhjetor 2013 me rastin e festave të fund vitit, duke i shtuar dhuratës së Bankës edhe dhurimet vullnetare të stafit në vlera financiare ose të mira materiale, për përmbushjen e nevojave bazike për këta fëmijë si dhe për t'u uruar Festat.

Ballo Shqiptare "Albanian Ball"

Banka mbështeti në fund të dhjetorit organizimin e Ballos Shqiptare "Albanian Ball", një event i nivelit të lartë organizuar nën kujdesin e Presidentit të Republikës. Intesa Sanpaolo Bank mbështet aktivitetet që kanë për qëllim ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e vlerave shpirtërore të shprehura në Art.

PROCREDIT BANK

Agrobizneset shqiptare prezantohen në tregun gjerman nga ProCredit Bank

Në 29 nëntor 2013, në Essen, Gjermani u organizua Dita Ekonomike, ku ProCredit Bank, mori pjesë bashkë me klientët e saj në fushën e agrobiznesit. ProCredit Bank u ofroi mundësinë partnerëve të saj, për promovimin e prodhimit agrokulturor, jo vetëm për kompanitë që operojnë në Ballkanin Perëndimor (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni), por edhe për kompani gjermane që shprehën interes për rritjen dhe forcimin e marrëdhënieve tregtare.

Ky aktivitet u dha mundësi bizneseve shqiptare në sektorin e agrobiznesit të krijojnë marrëdhënie të reja biznesi, për rritjen e standardeve dhe të eksporteve të prodhimit.



■ NBG BANK ALBANIA

Mbështet studentët e talentuar

Banka NBG Albania vazhdon bashkëpunimin me Fakultetin Ekonomik të Tiranës, në mbështetje të studentëve përmes iniciativave që synojnë aftësimin dhe përgatitjen e tyre për t'u prezantuar e afruar me tregun e punës. Në ceremoninë e diplomimit të studentëve të Fakultetit Ekonomik të Tiranës, Banka NBG Albania, ofroi për studentët më të spikatur mbulim të plotë financiar për vazhdimin e studimeve të tyre në nivelin Master. Gjatë vitit 2013, 20 studentë janë përfshirë në programin për praktikë pune në Bankën NBG Albania.



Mbështet "Shqipëria Dhuron"

Banka është bërë pjesë e fushatës "Shqipëria Dhuron" duke mbështetur aktivitete në qytete të ndryshme të vendit. Në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore në Gjirokastrë, banka ndau dhurata për 50 nxënësit e dalluar në festën e tyre të fund vitit. Në vijim të aktiviteteve në këtë qytet, nën sloganin "Gjirokastra Dhuron", në bashkëpunim me Shërbimin Social Rajonal dhe Prefekturën Gjirokastrë, u shpërndanë pako me ushqime për familjet në nevojë dhe dhurata për fëmijët jetim në qendrën "Vatra e Ngrohtë".



"Banka NBG Albania dhuron"

Në Berat, nën moton "Banka NBG Dhuron", u shpërndanë ndihma dhe dhurata për personat me aftësi të kufizuara. Nismës iu bashkua dhe stafi i bankës, i cili me kontribut tërësisht vullnetar përgatiti pako me ushqime dhe veshje, të cilat u shpërndanë në një aktivitet të organizuar në bashkëpunim me Shërbimin Rajonal dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nën kujdesin e ministrit Erion Veliq.

■ RAIFFEISEN BANK

Financon mbjelljen e 390 pemëve në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës

Më 17 dhjetor në parkun e Liqenit Artificial u organizua një ceremoni me rastin e sponsorizimit për mbjelljen e 390 pemëve nga Raiffeisen Bank në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, ku ishin të pranishëm drejtori i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank, Z. Christian Canacaris, dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Lulzim Basha. Z. Canacaris u shpreh se Raiffeisen Bank është e kënaqur që është ndër kompanitë e para që iu përgjigj thirrjes së Z. Basha për mbjelljen e pemëve të reja dhe shtimin e hapësirave të gjelbra në Tiranë.



Sponsorizon blerjen e materialeve spitalore për diagnostikimin e të sëmurëve dhe nevojat e klinikës Onkologjike në QSUT

Ministri i Shëndetësisë, Z. Ilir Beqaj dhe Z. Christian Canacaris, drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank në Shqipëri, nënshkruan një marrëveshje sponsorizimi sipas së cilës Raiffeisen Bank merr përsipër përballimin e shpenzimeve me një vlerë prej 30,000 euro për blerjen e materialeve spitalore, si kite dhe reagentë të nevojshëm për diagnostikimin e të sëmurëve për nevojat e klinikës onkologjike pranë QSUT-së. Gjatë ceremonisë Z. Canacaris u shpreh se Raiffeisen Bank është e ndjeshme ndaj situatës në këtë sektor kaq sensitiv, ndaj reagoi pozitivisht ndaj kërkesës së Ministrisë.



■ TIRANA BANK

Tirana Bank është pranë të moshuarve të vetmuar në Ditën Ndërkombëtare Kundër Varfërisë

Më 17 tetor, në Ditën Ndërkombëtare Kundër Urisë, Tirana Bank, iu bashkua nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar: "Mendoni për ata që nuk janë si ju". Në këtë kuadër, pranë zyrave të Kryqit të Kuq në Tiranë, Tirana Bank mundësoi shpërndarjen e 100 kutive me ushqime për të moshuarit e vetmuar.

Mbështetje për ndërgjegjësimin ndaj kancerit të gjirit

Tetori ishte muaji i vetëdijes së luftës kundër kancerit të gjirit. Këtë vit Tirana Bank iu bashkua nismës për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me hapat që mund të merren për të ulur rrezikshmërinë e saj, duke mbështetur fushatat në TV, si dhe prodhimin dhe shpërndarjen e posterave që promovonin ndërgjegjësimin dhe inkurajonin kontrollet. në zyrat e qendrore dhe të gjitha degët, për sensibilizimin e stafit të saj, klientëve dhe komunitetit.



LAJME NDËRBALLKANIKE

BOSNJE - HERCEGOVINË

**Huat me probleme rriten me 14.9 % në tremujorin e tretë të 2013-ës**

hispanicbusiness - 02.12.2013

Në tremujorin e tretë të vitit 2013, huat me probleme arritën 14.9 % të totalit të huave, nga 12.7% një vit më parë dhe 14.3% në fund të muajit qershor. Këto të dhëna u bënë publike nga Banka Qendrore. Sektori bankar i Bosnjë-Hercegovinës mbetet i mirëkapitalizuar, me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 17.0% në fund të shtatorit, nga 16.7 % një vit më parë. Në terma vjetorë, likuiditeti i sektorit bankar është përmirësuar dhe raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve arriti në 25.3% në fund të shtatorit, nga 24.8 % një vit më parë.

BERZH mbështet Sberbank me 10 milionë EURO

Balkans.com Business News Correspondent - 10.12.2013

BERZH është në proces të akordimit të një linje huaje prej 10 milionë Euro për Sberbank BH d.d. Fondet do të jepen në kuadër të ndihmës ndaj Kroacisë dhe Ballkanit Perëndimor dhe kanë për qëllim mbështetjen e bankave dhe institucioneve financiare jobankare, për rritjen e financimit të ndërmarrjeve të vogla. Deri më sot, BERZH ka investuar më shumë se 1.6 miliardë euro, në 110 projekte në Bosnjë-Hercegovinë, me fokus në zhvillimin e infrastrukturës, mbështetjen e ndërmarrjeve të mëdha dhe të vogla, si dhe në forcimin e sektorit financiar.

BULLGARIA

**Më tepër likuiditet tashmë për bankat bullgare**

Balkans.com Business News Correspondent - 11.06.2013

Bankat bullgare tani do të kenë më shumë likuiditet, pasi kërkesa e mjaftueshmërisë së kapitalit në minimumin e kërkuar prej 12% u hoq nga Ministria e Financave, nëpërmjet ndryshimit të aktit për institucionet e

financimit, raporton e përditshmja "Standart". Rregullat e reja do t'i japin bankave mundësinë për të dhënë më tepër hua. Në BE, kërkesa për mjaftueshmërinë e kapitalit është në nivelin 8%.

Bankat bullgare kanë dhënë shumë hua në valutë të huaj

Balkans.com Business News Correspondent - 11.08.2013

Në Bullgari ka një numër të madh bankash të pozicionuara më tepër rreth Sofjes dhe përgjatë bregdetit të Detit të Zi. Kur u pyetën për konkurrentët në lidhje me huadhënien ndaj NMV-ve, shoqërive të mëdha dhe individëve, të gjitha bankat që u përgjigjën, kishin arritur në të njëjtin përfundim: që bankat e huaja janë konkurrentë të fortë. Bullgaria është një ndër dy vendet e rajonit ku përqindja e bankave, të cilat bien dakord që informacioni mbi ligjet bankare është i qëndrueshëm dhe i parashikueshëm, është rritur gjatë periudhës 2007-2011.

GREQIA

**Moody's ka përmirësuar klasifikimin e obligacioneve të mbështetura nga huat hipotekore të pesë programeve të obligacioneve greke**

The Street - 11.12.2013

Moody's Corporation (MCO) ka përmirësuar nga B3 në Caa2, obligacionet e mbështetura nga huat hipotekore të pesë programeve të obligacioneve greke, përfshirë dhe Bankën Kombëtare të Greqisë (NBG). Përmirësimi mbulon vlerësimin e obligacioneve të mbështetura nga huat hipotekore të emetuara nga Alpha Bank A.E., sipas programit "Direct Issuance Global Covered Bond Programme", Eurobank Ergasias S.A. sipas të dy programeve të saj dhe të Bankës Kombëtare të Greqisë, po sipas të dy programeve të saj.

Ulja e ritmit të rritjes të huave me probleme

Balkans.com Business News Correspondent - 19.11.2013

Duket se ritmi i rritjes së huave të reja me probleme në Greqi është ulur dhe sipas deklaratave të zyrtarëve të bankës rezultatet e tremujorit të tretë do të pasqyrojnë uljen e ritmit të krijimit të huave me probleme. Kufizimi i huave me probleme është një çështje kyçe për të ardhmen e sektorit të huadhënies. Sipas burimeve nga bankat nëse ekonomia nuk vazhdon rritjen, sektori bankar do të jetë i detyruar të shohë sërish veten në një pozicion të vështirë.

KOSOVA



Përdorimi i kodeve SWIFT të institucioneve financiare

BQK - 12.06.2013

Më 9 dhjetor 2013 filloi përdorimi i kodeve të reja SWIFT të bankave në Kosovë, të cilat janë tashmë të lidhura drejtpërdrejt me SWIFT (ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, TEB, NLB Prishtina dhe Turkiye IS Bankasi e Kosovës). Këto kode SWIFT identifikojnë institucionet përkatëse si institucione të Republikës së Kosovës. Bankat kanë publikuar informacion më të detajuar në faqet e tyre të internetit.

Guvernatori i BQK-së, Bedri Hamza, merr pjesë në takimet vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore në Uashington

BQK - 10.12.2013

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, z. Bedri Hamza, i shoqëruar nga delegacioni i BQK-së, mori pjesë në takimet e rregullta vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore, të cilat u zhvilluan në Uashington. Gjatë takimeve, guvernatori Hamza siguroi mbështetjen e këtyre institucioneve për projektet në vazhdim dhe projekte të reja të ardhshme, të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar në Republikën e Kosovës.

KROACIA



Kroacia është gati për shpërndarjen e fondeve të BE-së

Balkans.com Business News Correspondent - 06.12.2013

Kroacia është gati për shpërndarjen e fondeve të marra nga Bashkimi Europian, deklaroi zëvendëskryeministri dhe ministri i Zhvillimit Rajonal dhe Fondet e BE-së, z. Branko Grčić, në një takim të kabinetit. Kroacia ka pasur akses në shumën prej 1.12 miliardë euro në të gjitha programet e BE-së, prej të cilave 806 milionë, ose 72 % janë miratuar nëpërmjet projekteve, sipas Grčić.

Banka Qendrore e Kroacisë parashikon rënie më të lehtë të PBB-së

Dalje - 15.10.2013

Sipas Bankës Kombëtare Kroate (HNB) pritet rënie më e lehtë e aktivitetit ekonomik në 2013, sesa rënia prej 1%, e parashikuar në korrik nga HNB. Rritja ekonomike pritet të mbetet e dobët në vitet në vijim.

Përsheptimi i rritjes mund të arrihet vetëm nëpërmjet aftësisë konkurruese të ekonomisë vendase, bazuar në reforma të gjera strukturore, deklaroi në njëjtë burim.

MALI I ZI



Rritje vjetore prej 5.4 % e aktiveve të bankave tregtare

Hispanic Business - 26.11.2013

Aktivet e bankave tregtare të Malit të Zi shënuan një rritje vjetore prej 5.4 %, në fund të muajit tetor, duke pasqyruar kryesisht rritje më të ngadaltë të cash-it dhe të depozitave të mbajtura në Bankën Qendrore, ndërkohë që pati një rritje të huadhënies ndaj sektorit privat gjatë kësaj periudhe. Të dhënat bëhen publike nga Banka Qendrore (CBCG). Raporti i aktiveve totale ndaj PBB-së qëndroi në 91 % në fund të muajit tetor, nga 85% një vit më parë, sipas përlogaritjeve të IntelliNews.

Mali i Zi planifikon të nënshkruajë një kontratë me Bankën Botërore mbi projektin "Eficiencia e Energjisë në Mal të Zi"

Balkans.com Business News Correspondent - 18.11.2013

Ministri i Financave të Malit të Zi, dr. Žugić Radoje, u takua me kreun e Zyrës së Bankës Botërore për Malin e Zi dhe Bosnjë-Herzegovinën, zj. Anabel Abreu. Gjatë takimit u diskutua gjendja e projekteve të zbatuara në Malin e Zi, që kishin të bënin me fushën e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit. U njoftua se negociatat në lidhje me projektin "Eficiencia në Mal të Zi", kanë përfunduar me sukses dhe hapi tjetër është nënshkrimi i marrëveshjes së huas në vlerë prej 5 milionë euro.

MAQEDONIA



BERZH rrit mbështetjen ndaj ndërmarrjeve maqedonase

Balkans.com Business News Correspondent - 20.12.2013

BERZH-i rrit mbështetjen ndaj ndërmarrjeve maqedonase me dy linja të huas ndaj Ohridska Banka Societe Generale. Huaja prej më shumë se 6 milionë Euro do të përdoret për të financuar investimet në eficiencën e energjisë dhe një hua e dytë prej 1 milion Euro do të akordohet për përmirësimin e konkurrencës së SME-ve. BERZH-i ka filluar të investojë në ekonominë e Maqedonisë në vitin 1993 dhe deri më tani ka nënshkruar mbi 80 projekte në vend.

Bankat duhet të mbështesin më shumë sektorin privat, deklaroi ministri i Financave

Balkans.com Business News Correspondent - 18.12.2013

Sektori bankar duhet të mbështesë më tepër kompanitë private. Bankat kanë stabilitet dhe nuk ekziston asnjë arsye për mos restaurim të aktivitetit kreditues, dhe

veçanërisht duke iu referuar disa bankave më të mëdha në vend, deklaroi zv.ministri dhe ministri i Financave, Zoran Stavreski, në FINEXPO 2013. Sektori bankar ka treguar një performancë pozitive gjatë këtij viti, me likuiditet të mjaftueshëm për të mbështetur projekte dhe kompani, si dhe për blerjen e letrave me vlerë dhe obligacioneve, tha Presidenti i Shoqatës së Bankave, Gjorgji Jancevski.

RUMANIA



Rumani, mbi 70% e transaksioneve të klientëve, të kryera përmes bankingut online - OTP Bank

Balkans.com Business News Correspondent - 12.12.2013


Z. Dragos Mindreci, drejtor i Bankingut Dixhital pranë OPT Bank Romania, tha se batingu nëpërmjet internetit ka rritur popullaritetin e tij, me mbi 70% të transaksioneve të klientëve të kryera online. Huadhënësi ka lançuar një version të ri të aplikimit të "mobile banking", OTPdirekt - Smart Bank, e aksesueshme nga smartphone-t dhe tablet-ët.

Tre bankat të cilat gëzojnë reputacionin më të mirë në Rumani

Balkans.com Business News Correspondent - 03.12.2013

ING Bank, Raiffeisen Bank and Banca Transilvania kryesojnë ndërmjet bankave me reputacionin më të mirë në Rumani, sipas studimit të kryer nga GfK, duke përdorur metodën "Reputation Management Model - RepMan®". ING Bank, Raiffeisen Bank, Banca Transilvania dhe BRD Societe Generale janë gjithashtu bankat kryesore për 60% të popullsisë në qytet. Sipas qytetarëve rumunë, banka me reputacionin më të mirë duhet të ketë orientim drejt klientit, të jetë tejet e përkushtuar ndaj kënaqësisë së tij dhe të udhëhiqet nga parime të tilla, si: ndershmëria, transparenca, etika dhe përgjegjshmëria.

SERBIA



Banka Kombëtare e Serbisë mandatohet për të forcuar stabilitetin e sistemit financiar

Balkans.com Business News Correspondent - 26.12.2013

Në takimin e datës 17 dhjetor, bordi ekzekutiv i Bankës Kombëtare të Serbisë aprovoi strategjinë për zbatimin e standardeve të Bazël III, si pjesë e përpjekjeve të saj

për të përmirësuar kuadrin rregullator të operacioneve bankare, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregullat e BE-së. Procesi do të jetë tërësisht transparent dhe strategjia si dhe çdo ndryshim i mundshëm do të publikohet në faqen zyrtare të Bankës Qendrore.

Banka Botërore do të financojë Serbinë me një hua prej 500 milionë dollarë

Balkans.com Business News Correspondent - 15.11.2013

Banka Botërore do të miratojë një hua prej 500 milionë dollarësh për Serbinë, për të mbështetur buxhetin dhe për të zbatuar reformat, ndërkohë që një hua prej 250 milionë dollarësh për etapën e parë të reformave do të miratohet në muajin shkurt ose mars 2014, deklaroi drejtoresha e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor zj. Ellen Goldstein. Zj. Goldstein specifikoi se mbështetja ndaj buxhetit të qeverisë së Serbisë nënkupton fonde për të papunët dhe programe të ndryshme, të cilat do të mundësonin personat të cilët humbasin punën e tyre të punësosheshin, ose të përfitonin aftësi të reja.

TURQIA



Bankat turke mund të përballen me vështirësi gjatë vitit 2014, nga rritja e normave të interesit

Balkans.com Business News Correspondent - 23.12.2013

Bankat turke mund të përballen me vështirësi gjatë vitit 2014, nga rritja e normave të interesit, ulja e rritjes ekonomike dhe dobësimi i lirës turke, deklaroi agjencia Fitch Ratings. Këto pritje do të kontribuojnë në një rënie modeste në marzhet e fitimit dhe rritje të fondeve për provigjone, por kapitalizimi i fortë dhe strukturat e shëndetshme të financimit do të ndihmojnë për të minimizuar ndikimin në cilësinë e huas, duke çuar në një perspektivë të qëndrueshme për sektorin. Luhatjet e mundshme të monedhës dhe interesave, përbëjnë një rrezik të lartë për sektorin bankar turk, pasi efektet e tyre do të transferohen te klientët dhe do të ulin cilësinë e huadhënies.

Turqia synon të forcojë rregulloret mbi huat dhe kartat e kreditit

Balkans.com Business News Correspondent - 14.11.2013

Kryeministri i Turqisë, z. Ali Babacan tha se Qeveria ka zbatuar rregulloren që lidhet me tre fusha të veçanta të shërbimeve financiare, përkatësisht të shërbimeve bankare, huave dhe kartave të kreditit. Qëllimi i këtyre masave rregullatore është rritja e kursimeve. Gjatë një konference për shtyp, të mbajtur në rastin e 10-vjetorit të sistemit privat turk të pensioneve (BES), z. Babacan tha: "Ne kemi zbatuar një sasi të madhe rregullash në këtë fushë. Mbikëqyrësi bankar (BDDK), Banka Qendrore, Thesari dhe Ministria e Zhvillimit kanë qenë në krye të procesit të analizës së ndikimit të këtyre projekteve".



nga Z. Oerd CUKALLA
Specialist i Sigurisë së TI,
Veneto Banka

Përdorimi i pajisjeve elektronike në jetën e përditshme ka lehtësuar veprimtaritë njerëzore në të gjitha fushat, duke ulur ndjeshëm kohët e pritjes që karakterizojnë më parë komunikimet në distancë. Bankat kanë përfituar nga zhvillimi i teknologjisë, për të pasur lidhje në kohë reale me përfaqësitë e tyre, për të kryer transaksione elektronike apo për të zhvilluar rrjetin tregtar duke vënë në dispozicion të klientëve sportele *online* me funksione të njëjta me sportelet reale.

Me zmadhimin e distancës së komunikimit janë shfaqur probleme të karakterit konfidencial që, sidomos në rastin e bankave, duhet të zgjidhen para se të mund të ofrohen shërbimet *online*. Për të zgjidhur këto probleme dhe për të mbrojtur fshehtësinë e komunikimeve, që prej viteve '90 përdoret kriptografia. Kriptografia dikur përkufizohej si shkenca e kodimit të të dhënave. Sot ajo bën të mundur që dy palë, sado larg të ndodhen, të mund të komunikojnë në fshehtësi me njëra-tjetrën në rast se aplikojnë me korrektesë protokollin e komunikimit.

Protokollin kryesor i komunikimit në kriptografi përdor të njëjtin çelës, si për shkrimin ashtu edhe për de-shkrimin e të dhënave; ky protokoll kriptografik quhet *kriptografi simetrike*. Palët që duan të komunikojnë

MBROJTJA E KOMUNIKIMEVE

Bankat kanë përgjegjësinë që, përveç vetes së tyre të mbrojnë edhe klientin dhe palët e tjera me të cilat bashkëpunojnë, kështu që institucionet financiare kanë qenë përherë pioniere të zhvillimit të komunikimeve të sigurta.

në mënyrë të fshehtë caktojnë një çelës (një fjalë, frazë apo një kombinim numrash e gërmash), që është sekret i palëve dhe që përdoret për të shifruar komunikimin në mënyrë që vetëm njohësit e këtij sekretit të jenë në gjendje ta deshifrojnë dhe të kuptojnë përmbajtjen. Natyrshëm lind nevoja e administrimit të çelësave, pasi çdo çift komunikuesish ka nevojë për një çelës të ndryshëm dhe, që komunikimi të jetë vërtet sekret, duhet që këta çelës të mbeten të fshehtë mes çdo çifti komunikuesish. Me gjithë përparësinë e ofruar nga shifrimi simetrik, bankat mbeten ende përballë disa problemesh të pazgjidhura: u duhet të ndajnë një çelës sekret me klientin (*komunikimi i çelësave*); të ruajnë fshehtësinë e një numri të madh çelësash (*administrimi i çelësave*); dhe, ç'është më e rëndësishmja, bankat dhe klientët duhet të sigurohen mbi identitetin e palës me të cilën po komunikojnë (*identifikimi i ndërsjellët*).

Përveç fushatave sensibilizuese bankat në Shqipëri kanë në dorë një instrument tjetër, momentalisht më efektiv, për rritjen e masave të sigurisë: investimin në certifikata elektronike të firmosura nga Autoritete Certifikuese të autorizuara.

Për fat, këtyre problemeve u është dhënë përgjigje nga një protokoll tjetër kriptografik, që është zhvillim i kriptografisë moderne: *shifrimi asimetrik*. Në këtë protokoll shifrimi secila palë ka dy çelës, një çelës privat dhe një publik. Çelësi publik vihet në dispozicion të publikut, ndërsa çelësi privat mbahet sekret. Protokollin e shifritimit është i tillë që mesazhet shifrohen me çelësin publik të marrësit dhe deshifrohen vetëm nga marrësi me çelësin e tij privat. Në një farë mënyre këto dy çelës mund të konsiderohen si të anasjelltë të njëri-tjetrit. Në disa raste dërguesi i mesazhit, përpara dërgimit, mund të aplikojë edhe një raund tjetër shifrimi me çelësin e tij privat, në mënyrë që marrësi të sigurohet për identitetin e dërguesit. Shifrimi asimetrik, përveç ruajtjes së fshehtësisë dhe zgjidhjes së problemit të komunikimit të çelësave, bën të mundur identifikimin e korrespondentit si dhe thjeshtëson dukshëm administrimin e çelësave, duke e ulur numrin e çelësave në një çift të vetëm për të gjitha komunikimet.

Për të mos u thelluar më tej në aspektet teknike të kriptografisë, më poshtë paraqitet një panoramë e përgjithshme mbi rolin praktik të kriptografisë në krijimin e komunikimeve të sigurta. Në zhargonin e sigurisë së informacionit *komunikime të sigurta* quhen komunikimet në të cilat: (1) palët pjesëmarrëse janë të identifikuar në mënyrë të pamohueshme, dhe (2) vetëm palët janë në gjendje të deshifrojnë përmbajtjen e komunikimeve. Këto kërkesa nuk janë të rastësishme. Bankat kanë përgjegjësinë që përveç vetes së tyre të mbrojnë edhe klientin dhe palët e tjera me të cilat bashkëpunojnë. Për

këtë arsye institucionet financiare kanë qenë përherë pioniere të zhvillimit të komunikimeve të sigurta. Për mbrojtjen e komunikimeve fillimisht janë përdorur tunele të shifruara dhe rrjete private virtuale (Virtual Private Networks, VPN). Më pas, me ngritjen e Autoriteteve Certifikuese (Certification Authorities, CA) apo me Infrastrukturat e Çelësave Publikë (PKI) komunikimet e shifruara u bënë të mundshme të përdoren prej masave. Në aktivitetin tonë të përditshëm, shpesh edhe pa qenë në dijeni, ne përdorim shumicën e këtyre elementeve. Në sajë të tyre jemi në gjendje të identifikojmë në mënyrë të pagabueshme sisteme, organizata apo individë që ndodhen në anën tjetër të globit. Kjo mbrojtje është e një rëndësie kritike në një kanal komunikimesh publik dhe anonim siç është Interneti.

Rrjetet private virtuale (VPN)

Rrjet privat është rrjeti kompjuterik i një dege i izoluar nga Interneti. Pajisjet në këto rrjete janë të mbrojtura nga sulmet e jashtme, për shkak të mungesës së komunikimit ose të prezencës së një pajisjeje që kontrollon komunikimet hyrëse dhe dalëse. Kështu degët funksionojnë si ishuj të vetmuar komunikimet e të cilave nuk mund t'i besohen Internetit publik dhe anonim. Me krijimin e rrjeteve private virtuale (VPN) bëhet i mundur zgjerimi i kufijve fizikë të rrjeteve private. Këto zgjerime krijohen duke ndërtuar kanale komunikimi të shifruar mes degëve të largëta. Në këtë mënyrë, largësia zhduket dhe komunikimet kryhen në mbrojtje dhe fshehtësi të plotë nga Interneti. Me anë të VPN-së bëhet gjithashtu

Kriptografia dikur përkufizohej si shkenca e kodimit të të dhënave. Sot ajo bën të mundur që dy palë, sado larg të ndodhen, të mund të komunikojnë në fshehtësi me njëra-tjetrën në rast se aplikojnë me korrektësi protokollin e komunikimit.



i mundur konsultimi i burimeve të brendshme të rrjetit nga personeli, që nuk ndodhet fizikisht në zyrë ose nga furnitorët e shërbimeve të ndryshme.

Shtrësia e komunikimeve të sigurta (SSL)

SSL në thelb është një protokoll komunikimi i shifruar që gërsheton shifrimin simetrik, për shpejtësinë e kryerjes së llogaritjeve me atë asimetrik, për thjeshtësinë e shpërndarjes së çelësve. Protokollin funksionon në dy faza kryesore. Në fazën e parë, klienti dhe banka përdorin kriptografinë asimetrike, për t'u siguruar për identitetin reciprok dhe për të shkëmbyer një çelës. Në fazën e dytë ngrihet komunikimi i vërtetë mes palëve, që përdor shifrimin simetrik me çelësin sekret të shkëmbyer në fazën e parë. Pas përmirësimeve të vazhdueshme që ka pasur, varianti 3.0 konsiderohet si i sigurt nëse përdoren çelësa simetrikë të gjatësisë mbi 128-bit. Ky protokoll përdoret nga klientët kur konsultojnë shërbimet e-banking dhe kryejnë pagesa online dhe identifikohet nga parashtesa *https://* në adresën e Internetit.

Autoritetet Certifikuese (CA)

Rritja e përdorimit të kriptografisë asimetrike, lindi nevojën për certifikimin e çelësve publikë të institucioneve. Për t'i bërë ballë kësaj nevoje u vendos krijimi i disa enteve që quhen Autoritete Certifikuese dhe funksionojnë si noterë për dhënien e certifikatave elektronike. Certifikata elektronike nuk është gjë tjetër veçse një çelës SSL publik, të cilit i aplikohet firma elektronike e një autoriteti certifikues. Kjo bën që programet e lundrimit në Internet, si: Chrome apo Firefox, të jenë në gjendje të verifikojnë vërtetësinë e certifikatave elektronike. Shpesh na qëllon që të përballëmi me mesazhe paralajmëruese në

rast se certifikatat nuk rezultojnë të jenë firmosur nga autoriteteve certifikuese të autorizuar.

Probleme për klientët

Firmat elektronike të autoriteteve certifikuese të autorizuar janë të publikuara dhe njihen prej çdo pajisjeje elektronike të aftë për të përdorur protokollin SSL. Kur lundruarit e Internetit na paralajmërojnë për prejardhje të dyshimtë të certifikatave duhet të bëjmë kujdes ekstrem dhe përgjithësisht, të mos plotësojmë formularë me informacione konfidenciale. Në rast se vendosim të vazhdojmë komunikimin, duhet të jemi të vetëdijshëm që komunikimi nuk është sekret dhe identiteti i palës tjetër nuk është i garantuar. Paralajmërimet e tilla nga lundruesi shpesh duan të thonë që institucioni nuk ka investuar në një certifikatë të firmosur nga një Autoritet Certifikues, por mund të jenë edhe tregues që komunikimi po manipulohet nga një palë e tretë.

Probleme për bankat

Përveç përgjegjësisë për të informuar klientët mbi rreziqet ndaj të cilave ekspozohen, bankat kanë edhe përgjegjësinë për të gjetur kompromisin e duhur mes masave të sigurisë dhe përdorueshmërisë së shërbimeve të sigurta. Është vërtetuar që, përdoruesit komprometojnë çdo masë për rritjen e sigurisë që u ndërlikon atyre aktivitetin, rëndësia e të cilës nuk u është bërë e qartë. Përveç fushatave sensibilizuese bankat në Shqipëri kanë në dorë një instrument tjetër, momentalisht më efektiv, për rritjen e masave të sigurisë: investimin në certifikata elektronike të firmosura nga Autoritetet Certifikuese të autorizuar. Në këtë mënyrë, paralajmërimet për originalitetin e certifikatave do të na bëjnë të shqetësohemi e nuk do të jenë në rendin e ditës.



A global reach with a local touch.

♦ **Head Office: Italy**

♦ **International Subsidiary Banks**

Albania	Russian Federation
Bosnia and Herzegovina	Serbia
Croatia	Slovakia and Czech Rep.
Egypt	Slovenia
Hungary	Ukraine
Romania	

♦ **International Corporate Banks**

Dublin
Luxembourg

♦ **Equity Investment**

Qingdao (China)

♦ **Foreign Branches**

Amsterdam
Dubai
Frankfurt
Hong Kong
London
Madrid
New York
Paris
Shanghai
Singapore
Tokyo
Warsaw

♦ **Representative Offices**

Abu Dhabi	Casablanca	São Paulo
Athens	Ho Chi Minh City	Seoul
Beijing	Istanbul	Stockholm
Beirut	Moscow	Sydney
Brussels	Mumbai	Tunis
Cairo	Santiago	

Leader in Italy thanks to its incomparable branch network, Intesa Sanpaolo is a major International Banking Group present in 40 countries with 11 International Subsidiary Banks, 2 International Corporate Banks, 12 Foreign Branches and 17 Representative Offices. The Group is capable of satisfying various levels of assistance and meeting the requirements of a highly diverse clientele, supplying operations and financial activities addressed to both households and enterprises.

- ♦ Retail and SME banking, private banking, bancassurance, consumer and industrial credit, payment systems, pension funds, fiduciary services, non-profit entities relations.
- ♦ Corporate banking, capital markets and investment banking, structured and public finance, merchant banking, leasing, factoring and transaction services.
- ♦ Asset management.
- ♦ Financial advisory.

INTESA  **SANPAOLO**

Visit us on group.intesasanpaolo.com



nga Z. Roberto RUOZI
Professor Emeritus
Università Bocconi di Milano

Praktikat ndërkombëtare e përkufizojnë bankungun privat si veprimtari e menaxhimit të aktiveve, veçanërisht aktiveve financiare, të një madhësie të konsiderueshme, të cilat i përkasin familjeve me të ardhura të larta, e që përgjithësisht njihen si individë të pasur. Në parim, ndërmjetësit financiarë, që janë aktivë në këtë fushë, vendosin disa kufij të poshtëm (minimume) për aktivet që ata marrin përsipër t'i menaxhojnë. Këta kufij janë të ndryshëm për vende të ndryshme. Në Itali p.sh.: kufiri është vendosur në 500 mijë Euro. Në SHBA dhe në vende të tjera shumë të zhvilluara, ky kufi është vendosur respektivisht në 1 milion USD ose Euro. Megjithatë, bankat e angazhuara në bankungun privat janë elastike në vendosjen e kufijve dhe shpesh janë të gatshme të pranojnë aktive me vlerë më të vogël, veçanërisht kur bëhet fjalë për të tërhequr klientë të rinj.

Klientët, zakonisht janë të sofistikuar dhe me kërkesa të larta, e kërkojnë trajtim të personalizuar e në shumë raste produkte financiare të përgatitura enkas për ta. Kriteret mbi të cilat mbështetet menaxhimi i aktiveve të klientëve natyrisht që janë të ndryshme dhe pasqyrojnë oreksin (prirjen) për rrezik të klientëve, i cili përcakton kështu pritshmërinë për kthimin. Rrjedhimisht, profesionalizmi i bankierëve privatë duhet të jetë i lartë e ata duhet të kenë njohuri të gjera e të thella për të gjithë segmentet e tregtisë financiare, në të gjithë tregjet e mëdhenj ndërkombëtarë. Diversifikimi i portofoleve, veçanërisht në terma të produkteve dhe të tregjeve, është në fakt një element bazë për suksesin e bankigut privat. Në përgjithësi, ai rritet me rritjen e portofoleve dhe rritjen

ÇËSHTJE DHE PIKËPAMJE RRETH BANKINGUT PRIVAT

Bankingu privat nuk është një profesion i thjeshtë, për më tepër që së fundi ka qenë objekt i një vëmendjeje edhe më të lartë nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

e edukimit financiar të klientëve. Për më tepër, ky i fundit ndryshon nga një vend në tjetrin, duke pasqyruar kështu shkallën e zhvillimit të tregjeve përkatës.

Përveç profesionalizmit, bankingu privat kërkon, gjithashtu, një konfidencialitet të lartë, i cili ka qenë një nga kërkesat bazë për menaxherët e aktiveve financiare dhe në përgjithësi për bankierët, pa lënë mënjanë transparencën, veçanërisht kur bëhet fjalë për termat dhe kushtet e kontratave me klientët. Këto kushte kanë të bëjnë me komisionet që u ngarkohen klientëve, të cilat lidhen me menaxhimin, ecurinë dhe tregtimin e letrave me vlerë. Ekziston një debat i madh, në nivel ndërkombëtar, mbi mundësinë e modifikimit të metodave të shpërblimit të bankierëve privatë, me qëllim që të sigurohet që këta menaxherë të ndajnë me klientët e tyre, jo vetëm kthimin pozitiv të menaxhimit, por gjithashtu dhe atë negativ, veçanërisht kur tregjet nuk janë në ditët e tyre më të mira, për sa i përket ecurisë.

Është e qartë që bankingu privat nuk është profesion i thjeshtë. Për më tepër dhe veçanërisht në vitet e fundit ai ka qenë objekt i një vëmendjeje edhe më të lartë nga ana e autoriteteve mbikëqyrëse

kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilët e kanë rregulluar nëpërmjet një disipline shumë të fortë, si në aspektet e marrëdhënieve me klientët, ashtu dhe në drejtim të përpjekjeve kundër pastrimit të parave dhe trajtimit të transaksioneve me palët përkatëse. Megjithatë, bankingu privat mund të kryhet nga tipa të ndryshëm ndërmjetësish financiarë. Për shembull, në Itali ky aktivitet kryhet nga 226 ndërmjetës, nga të cilët 50 janë banka tregtare italiane, 35 janë banka të huaja, 10 janë banka të specializuara (institucione të mirëfillta të përfshira në bankingun privat), 22 janë shoqëri dhe butikë financiarë, 4 janë rrjete të konsulentëve financiarë dhe 105 janë zyra familjare

Për më tepër, bankingu privat është duke u zhvilluar vullshëm dhe ka një treg të madh potencial, megjithë krizën financiare që filloi në vitin 2007. Aktualisht, në vitin 2012 numri i klientëve potencialë në mbarë botën, i kaloi 12 milionët, me një rritje rreth 10 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Aktivitetet e tyre i kalojnë 46,000 miliardë dollarë amerikanë, të cilat flasin gjithashtu për një rritje rreth 10 për qind, kundrejt vitit të kaluar. Progres më të mirë në profesionin e bankingut privat kanë regjistruar vendet e Amerikës Veriore dhe ato të Azisë

Natyrisht jo të gjithë klientët potencialë kthehen eventualisht në klientë faktikë. Në Itali, për shembull, vlera e aktiveve të menaxhuara nga bankierët privatë shkon afërsisht në 50 për qind të tregut potencial.

Në Shqipëri, bankingu privat është ende në fazat e para të zhvillimit të tij, duke vënë në pah, megjithatë, disa lëvizje të suksesshme të disa bankave, që i përkasin grupeve ndërkombëtare. Aktualisht, përmbajtja teknike e kësaj veprimtarie është mjaft modeste dhe kufijtë minimalë të pjesëmarrjes janë mjaft të ulëta. Duke qenë se përqendrimi i pasurisë në vend duket mjaft i lartë, siç evidentohet nga fakti që 5 për qind e depozituesve në banka zotërojnë rreth 58 për qind të shumës totale të depozitave bankare, e ardhmja e kësaj industrie është shumë inkurajuese. Përmirësimi progresiv i strukturës dhe funksionimit të sistemit financiar vendas, gjithashtu, do të nxisë kërkesën në këtë drejtim. Hyrja e Shqipërisë në Bashkimin Europian do të ishte mjaft e rëndësishme, pasi do të hapte horizonte të reja të rëndësishme për investimin e kursimeve kombëtare.

BANKINGU PRIVAT¹⁾

Bankingu privat formon një nëngrup të rëndësishëm dhe të veçantë të menaxhimit të pasurisë. Deri pak kohë më parë, ai ka qenë i përqendruar kryesisht në shërbimet bankare (të tilla si: pranimit të depozitave dhe kryerja e pagesave), menaxhim rastësor të aktiveve, shërbime komisionere, shërbime të kufizuara këshillimi për taksat, si dhe disa shërbime të përgjithshme të dorës së dytë të tipit të kujdestarisë, të ofruar nga një menaxher i veçantë për marrëdhëniet me klientët. Në përgjithësi, shumë klientë i besonin menaxherëve të marrëdhënieve të bankingut privat për të vijuar këtë menaxhim fondesh, duke mbajtur kështu qëndrim pasiv në vendim-marrjen financiare.

Bankingu privat ka një trashëgimi shumë të hershme, duke filluar që nga shekulli i shtatëmbëdhjetë me disa banka private britanike. Megjithatë, vetëm në këto dy dekadat e fundit, termi “menaxhim i pasurisë” ka gjetur vend në fjalorin e përbashkët të kësaj industrie. Ai u zhvillua si përgjigje e mbërritjes së një pasurimi masiv nga fundi i shekullit të njëzetë; kërkesave më të rafinuara të klientëve përgjatë gjithë spektrit të pasurisë; dëshirës së klientëve për të qenë të përfshirë aktivisht në menaxhimin e parave të tyre; gatishmërisë nga ana e disa ofruesve të shërbimeve financiare, të tilla si: bankat, që ofrojnë shërbime me pakicë dhe shoqërive komisionere, për të shtrirë apo zgjeruar ofertat e tyre, në plotësim të kërkesave të reja të klientëve; e përgjithësisht, ndërgjegjësimit të ofruesve të këtyre shërbimeve se, për shumë klientë, shërbimet e përgjithshme financiare të tregut me pakicë nuk ishin më të përshtatshme. Menaxhimi i pasurisë, si rrjedhim, është një fushë më e gjerë e shërbimeve financiare, kundrejt bankingut privat, në dy mënyra:

GAMA E PRODUKTEVE. Ashtu si në bankingun privat, shërbimet e menaxhimit të aktiveve janë në themel të industrisë së menaxhimit të pasurisë, por menaxhimi i pasurisë është më shumë se menaxhim i aktiveve. Ai lidhet me të dyja anët e bilancit kontabël të klientëve. Menaxhimi i pasurisë i vë theks dhe më të madh këshillimit financiar dhe lidhet me mbledhjen, mbajtjen, ruajtjen, rritjen dhe transferimin e pasurisë. Ai përfshin tipat e mëposhtëm të produkteve dhe shërbimeve:

- a) Brokerimi apo shërbimet komisionere.
- b) Produktet kryesore bankare, të tilla si: llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat dhe menaxhimin e likuiditetit.
- c) Produktet e huadhënies, të tilla si: llogaritë me pjesëmarrje, kartat e kreditit, huat hipotekore dhe financimi i avionëve privatë.
- d) Produktet që lidhen me mbrojtjen dhe siguracionet, të tilla si: sigurimi i pronës dhe shëndetit, sigurimi i jetës dhe pensionet.
- e) Menaxhimi i aktiveve në kuptimin e tij më të gjerë: sipas interesit më të mirë ose mbi baza këshillimore, menaxhimi të aktiveve financiare dhe jofinanciare (të tilla si: pasuritë e paluajtshme, mallra të ndryshëm, verëra dhe vepra arti), investime konvencionale, të strukturuar apo investime alternative.
- f) Këshillim në të gjitha trajtat dhe format: shpërndarje e aktiveve, strukturim i pasurisë, taksa dhe shërbimet e mirëbesimit, tipa të ndryshëm të planifikimit (financiar, trashëgimive, të pensioneve apo bamirësive), ndërmjetësim i çështjeve të diskutueshme familjare – deri te psikoterapia për fëmijët që vuajnë nga ‘influenca’ (sindroma e të jetuarit në një shoqëri të pasur).
- g) Një gamë të gjerë të shërbimeve të kujdestarisë, si: porositë për jahte, ruajtja e veprave të artit, vendndodhja e pasurive të paluajtshme, rezervimi në hotele, restorante apo teatro.
- h) Mbështetur në kërkimet e Boston Consulting Group, investimet jo në fonde likuide, mund të llogariten në jo më shumë se 36% të totalit të të ardhurave nga menaxhimi i pasurisë në rrafsh global.

SEGMENTET E KLIENTËVE. Bankingu privat shënjestrën vetëm klientët shumë të pasur: me fjalë të tjera, ata klientë pasuria e të cilëve shkon më shumë se rreth 1 milionë USD, në aktive të investueshme. Përkundrazi, menaxhimi i pasurisë shënjestron klientë me aktive rreth 100 mijë USD, d.m.th. klientë të pasur, sikurse dhe ata shumë të pasur.

¹⁾ Global Private banking Wealth Management – The New Realities, David MAUDE, 2006, p.1.

VEPRIMTARITË E SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

AAB – AKTIVITETE

EDUKIMI FINANCIAR, 20 NËNTOR 2013

Në kuadër të fushatës së edukimit financiar, AAB prezantoi në mjediset e shkollës “Fan S. Noli” paketën e re mësimore “1,2,3 ... Derrkuci Çufo mëson të kursejë”, dedikuar nxënësve që ndjekin klasën I-rë, II-të, dhe III-të të shkollave 9 vjeçare. Këtë vit AAB mundësoi shpërndarjen falas të 2500 kopjeve të kësaj pakete.



AAB NËNSHKRUAN MEMORANDUMIN E BASHKËPUNIMIT ME MMSR, 24.12.2013

Memorandumi i Bashkëpunimit midis bankave anëtare të AAB-së dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) ka për qëllim krijimin e formave të bashkëpunimit që konsistojnë në aktivitete të përbashkëta, për realizimin e praktikave të nxënësve të arsimit profesional. Memorandumi u nënshkrua nga Ministri i MMSR-së, z. Erion Veliaj dhe Kryetari i AAB-së, z. Seyhan Pencablilig.



AAB ORGANIZON DARKËN PËR FESTAT E FUNDVITIT, 17 DHJETOR 2013

AAB organizoi darkën e përvitshme të fundvitit me drejtuesit dhe përfaqësues të tjerë nga bankat anëtare, Guvernatorin Z. Ardian Fullani, dhe të ftuar të tjerë nga Banka e Shqipërisë, si dhe anëtarët e Bordit Editorial të Revistës “Bankieri”. Të ftuar nderi në këtë mbrëmje ishin edhe Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Z. Ettore Sequi, dhe Z. Nadeem Ilahi, Drejtues i Misionit të FMN-së për Shqipërinë.



AAB – TRAJNIME



“BANKINGU PERSONAL”
4 tetor 2013



“OPERACIONET E KREDIVË TREGTARE”
7-9 tetor 2013



“GARANCITË DHE TË ARKËTUESHMET”
10-11 tetor 2013



PCI DSS
24-25 tetor 2013



“AUDITIMI NË THESAR – NJË GUIDE PRAKTIKE”
11-12 nëntor 2013



“MENAXHIMI I SIGURISË NË BANKA”
16-18 dhjetor 2013

